



COUNCIL OF EUROPE    CONSEIL DE L'EUROPE

Strasbourg, 2 Mars 2006

ACFC/OP/I(2005)004

**KOMISIONI KËSHILLËDHËNËS MBI KONVENTËN KORNIZË PËR  
MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE**

**OPINIONI MBI IMPLEMENTIMIN E KONVENTËS KORNIZË PËR MBROJTJEN  
E PAKICAVE KOMBËTARE NË KOSOVË**  
(i miratuar më 25 nëntor 2005)

**Përmbajtja:**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
I. PËRGATITJA E OPINIONIT AKTUAL.....	5
II. VËREJTJET E PËRGJITHSHME.....	6
Rëndësia e Marrëveshjes mbi monitorimin e Konventës Kornizë .....	6
Funksionimi i procesit monitorues.....	7
Përgjegjësitë për implementimin e Konventës Kornizë.....	8
Trashëgimia e së kaluarës së vonshme .....	9
III. KOMENTE SPECIFIKE LIDHUR ME NENET 1-19.....	11
Neni 1 .....	11
Neni 2.....	11
Neni 3.....	11
Neni 4.....	14
Neni 5.....	18
Neni 6.....	19
Neni 7.....	20
Neni 8.....	21
Neni 9.....	22
Neni 10.....	23
Neni 11.....	25
Neni 12.....	26
Neni 13.....	30
Neni 14.....	30
Neni 15.....	33
Neni 16.....	35
Neni 17.....	36
Neni 18.....	37
IV. VËREJTJET PËRMBYLLËSE .....	38
KONKLUDIMET E PËRGJITHSHME .....	38
REKOMANDIMET .....	40
Të përgjithshme .....	40
Mbledhja e të dhënave .....	40
Masat ligjore dhe zbatimi i ligjit.....	40
Procesi i kthimit dhe shqetësimet për siguri .....	41
Kulturat e pakicave dhe çështjet mediale.....	41
Përdorimi i gjuhës .....	41
Arsimi .....	42
Pjesëmarrja.....	42
Mbrojtja ndaj ndryshimeve të popullatës.....	43
Kontaktet ndërkufitare .....	43

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Pas pranimit të Raportit të dorëzuar nga UNMIK-u më 2 qershor 2005 (planifikuar për 23 shkurt 2005), Komisioni Këshillëdhënës filloi ekzaminimin e implementimit të Konventës Kornizë në Kosovo. Në kontekst të këtij ekzaminimi, një delegacion i Komisionit Këshillëdhënës e vizitoi Kosovën prej 11 – 15 tetor 2005 në mënyrë që të kërkojë më tepër informata. Komisioni Këshillëdhënës e miratoi qëndrimin mbi Kosovën në takimin e vet të njëzet e katërt më 25 nëntor 2005.

Opinionin aktual bazohet në Marrëveshjen e arritur në mes të Këshillit të Evropës dhe UNMIK-ut lidhur me monitorimin e Konventës Kornizë. Kjo marrëveshje është hap i rëndësishëm në përmirësimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të autoriteteve në Kosovë në fushën e mbrojtjes së pakicave.

Implementimi dhe monitorimi i Konventës Kornizë është posaçërisht sfidues në Kosovë. Kompleksiteti i rregullimit institucional të Kosovës nënkupton se përgjegjësitë përkatëse të autoriteteve të ndryshme ndërkombëtare e vendore nuk janë gjithmonë të qarta. Pasiguria e statusit të ardhshëm të Kosovës edhe më tej e ndërlikon këtë pamje.

Implementimi i pothuajse të gjitha parimeve të Konventës Kornizë është bërë tejet i vështirë nga fakti se dhuna ndëretnike ka dëmtuar rëndë besimin në mes të komuniteteve.

Normat e ndryshme të avancuara, si Ligji Kundër Diskriminimit dhe plani i lavdërueshëm për zbatimin e standardeve janë paraqitur në mënyrë që të trajtojnë shqetësimet kyçe të komuniteteve pakicë.

Sidoqoftë, realiteti në Kosovë mbetet mjaft larg nga këto norma dhe plane të lavdërueshme. Armiqësia në mes të shqiptarëve dhe serbëve ende është mjaft e prekshme, situatë kjo që poashtu dëmton mbrojtjen e komuniteteve tjera në Kosovë, prej të cilave romët janë në pozitë veçanërisht të vështirë.

Serbët jashtë vendbanimeve të tyre kompakte shohin të kërcënuara të drejtat e tyre themelore duke përfshirë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e të shprehurit kurse diskriminimi dhe mostoleranca ndaj personave që i takojnë komuniteteve pakicë vazhdojnë. Shqetësimet e ndërlidhura të sigurisë, mundësitë e kufizuara të punësimit, problemet me riposedimin e pronës e faktorë të tjerë, janë pengesë reale për kthimin e qëndrueshme të personave të zhvendosur si pasojë e dhunës ndëretnike.

Ka pasur ca progres në implementimin e Konventës Kornizë në fushat si arsimit, përdorimi i gjuhëve në jetën publike e private dhe në pjesëmarrje. Sidoqoftë, këta hapa pozitivë mbeten të pamjaftueshëm në lidhje me nevojat e shprehura, duke përfshirë ato të shprehura nga personat që numerikisht ju takojnë komuniteteve më të vogla pakicë shumica e të cilëve nuk kanë shtet amë.

Është thelbësore që institucionet kryesore ta ndërtojnë edhe më tej besimin te komunitetet pakicë, përmes rritjes së profesionalizmit dhe duke i adresuar në mënyrë efektive incidentet ndëretnike dhe shqetësimet tjera të personave që ju takojnë komuniteteve të ndryshme. Në disa institucione të caktuara, ky besim është lehtësuar nga prania e konsiderueshme ndërkombëtare siç është rasti edhe me institucionin e Ombudspersonit.

Pjesëmarrja efektive e personave që ju takojnë komuniteteve pakicë është një lëmi kyçe ku, pavarësisht nga garanci të caktuara pozitive, progresi i mëtejshëm është i një rëndësie të veçantë duke përfshirë fushën e gjyqësisë dhe sektorëve tjerë të rëndësishëm. Ky parim duhet të pasqyrohet edhe në bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës që do të duhej të përfshinin jo vetëm serbët dhe shqiptarët por edhe përfaqësues të komuniteteve tjera.

## I. PËRGATITJA E OPINIONIT AKTUAL

1. Opinioni aktual mbështetet në Marrëveshjen në mes të Këshillit të Evropës dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më tej: UNMIK) mbi Rregullimet Teknike Lidhur me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, nënshkruar më 23 gusht 2004 (më tej: Marrëveshja).
2. Mbështetur në Nenin 2 të Marrëveshjes së lartpërmendur, UNMIK-u dorëzoi një raport mbi masat legislative dhe të tjera të ndërmarra për t'i implementuar parimet e parashtruara në Konventën Kornizë më 2 qershor 2005 (më tej: "Raporti i UNMIK-ut"). Neni 2 i Marrëveshjes poashtu parasheh se pas pranimit të informatave nga UNMIK-u dhe opinionit të Komisionit Këshillëdhënës mbi Konventën Kornizë, Komiteti i Ministrave do të shqyrtojë dhe miratojë konkludimet e veta lidhur me domosdoshmërinë e masave të ndërmarra për t'iu dhënë efekt parimeve të Konventës Kornizë. Poashtu mund të miratojë rekomandime për UNMIK-un dhe të caktojë një afat kohor për dorëzimin e informatave për implementimin e tyre.
3. Në kontekstin e përgatitjes së këtij Opinioni, një delegacion i Komisionit Këshillëdhënës e vizitoi Kosovën prej 11 deri më 15 tetor 2005 në mënyrë që të sigurojë informata shtesë nga përfaqësuesit e autoriteteve si dhe nga OJQ-të dhe burimet tjera të pavarura mbi implementimin e Konventës Kornizë. Gjatë përgatitjes së këtij opinioni, Komisioni Këshillëdhënës poashtu ka konsultuar një sërë materialesh të shkruara nga organet e ndryshme të Këshillit të Evropës, organizatave tjera ndërkombëtare, OJQ-ve dhe burimeve tjera të pavarura.
4. Komisioni Këshillëdhënës më pastaj e miratoi këtë opinion në mbledhjen e vet të njëzet e katërt më 25 nëntor 2005 dhe vendosi t'jua përcjellë Komitetit të Ministrave.
5. Në përgjithësi, Komisioni Këshillëdhënës është përpjekur të përcjellë strukturën dhe metodologjinë e përdorur në ciklin e parë të monitorimit, por është e qartë që specificiteti i gjendjes në Kosovë dhe modalitetet monitoruese kanë ndikuar në procesin dhe në Opinionin vijues. Për shembull, Komisioni e pa të domosdoshme të ketë një seksion më të gjerë të komenteve të përgjithshme se që ka qenë rasti me ciklin e parë të Opinioneve të Komisionit Këshillëdhënës, duke pasur parasysh se shumë nga sfidat e përgjithshme të përmendura janë në thelb të problemeve të implementimit të neneve specifike të Konventës Kornizë.

## II. VËREJTJET E PËRGJITHSHME

6. Fillimisht, Komisioni Këshillëdhënës dëshiron të theksojë se edhe në rrethana të jashtëzakonshme që mbizotërojnë në Kosovë – ku autoritetet ndërkombëtare luajnë rol të rëndësishëm dhe ku çështja e statusit të ardhshëm të Kosovës mbetet e hapur – implementimi i Konventës Kornizë duhet të shihet si përgjegjësi kyçe e të drejtave të njeriut të autoriteteve përkatëse, dhe të mos minohet nga zhvillimet politike apo institucionale.

### Rëndësia e Marrëveshjes mbi monitorimin e Konventës Kornizë

7. Marrëveshja e arritur në mes të Këshillit të Evropës dhe UNMIK-ut për monitorimin e Konventës Kornizë në Kosovë është e një rëndësie të posaçme. Paraqet hap unik në përmirësimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të autoriteteve në Kosovë në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare, që është një fushë e rëndësishme kyçe për të drejtat e njeriut si dhe për paqen dhe stabilitetin në Kosovë. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret qasjen pragmatike të të gjithëve – duke përfshirë Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, UNMIK-un, Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (më tej: IPVQ-të) dhe autoritetet e Serbisë dhe Malit të Zi – në arritjen e kësaj marrëveshje precedenti në një kontekst ligjor dhe institucional kaq të ndërlikuar dhe politikisht të ndjeshëm.
8. Edhe pse të drejtat dhe liritë e parapara në Konventën Kornizë janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë pas miratimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme më 15 maj 2001, Konventa Kornizë nuk është përdorur apo nuk ka qenë në dijeni të madhe nga ana e autoriteteve përkatëse apo publikut. Është e qartë se Marrëveshja dhe procesi vijues i monitorimit kanë ndihmuar në rritjen e rëndësisë së vetëdijesimit të institucioneve të Kosovës për Konventën Kornizë dhe shpresohet se ky trend edhe më tej do t'i intensifikojë fazat e ardhshme të monitorimit. Marrëveshja poashtu e qartësoi përkushtimin e UNMIK-ut ndaj Konventës Kornizë duke siguruar se UNMIK-u do t'i ushtrojë detyrat e veta në përputhje me parimet e parapara në Konventën Kornizë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në dritën e faktit se, përderisa Korniza Kushtetuese qartas parasheh se IPVQ-të duhet t'i "monitorojnë dhe sigurojnë" të drejtat dhe liritë përbrenda Konventës Kornizë dhe t'i bëjnë ato drejtpërdrejtë të aplikueshme, Rregullorja Ligjore e Aplikueshme e UNMIK-ut, pas ndryshimit,<sup>1</sup> nuk përfshin Konventën Kornizë në listën e standardeve të të drejtave të njeriut ku "të gjithë personat me detyra publike apo që mbajnë poste publike në Kosovë" janë të obliguar, *në veçanti*, të monitorojnë. Përderisa lista nuk është shteruese, ajo lë të kuptohet se traktatet e renditura konsiderohen prioritare. Është me rëndësi se kjo mangësi është adresuar dhe monitorimi i Konventës Kornizë qartas përfshihet si detyrë kyçe për të gjitha autoritetet e ardhshme, ndërkombëtare e vendore, që merren me çështjet e pakicave në Kosovë.
9. Rëndësia e procesit aktual të monitorimit të Konventës Kornizë poashtu njihet në Planin për Zbatimin e Standardeve për Kosovën të datës 6 korrik 2004, i cili përfshin

<sup>1</sup> Rregullorja e UNMIK-ut No. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, e ndryshuar nga Rregullorja No. 2000/59 e 27 tetorit 2000.

përkushtim të qartë për shqyrtimin dhe implementimin e rekomandimeve të dala nga procesi monitorues i Konventës Kornizë. Duke pasur parasysh se rekomandimet e tilla tek tani janë duke u formuluar, është primare të ruhet ky përkushtim në çfarëdo revidimi të planit për zbatimin e standardeve dhe të përcillet energjikisht. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme tani kur bisedimet për statusin e Kosovës janë në zhvillim e sipër. Siç është cekur drejtë nga Z. Kai Eide, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së në shqyrtimin e tij gjithëpërfshirës të situatës në Kosovë në tetor 2005, është e “rëndësishë kyçe që resurse të mjaftueshme të mobilizohen për të siguruar vazhdimin e implementimit të standardeve me energji të padobësuar dhe me një ndjenjë më të fortë përkushtimi”.

### **Funksionimi i procesit monitorues**

10. Sa i përket kontributit në procesin e monitorimit deri më tani, Komisioni Këshillëdhënës është mirënjohës ndaj përpjekjeve për përpilimin e Raportit të UNMIK-ut. Komisioni Këshillëdhënës njih faktin se UNMIK-u, posaçërisht Shtylla III e cila ishte e ngarkuar me pjesën më të madhe të përgatitjes së Raportit, ka ndërmarrë detyra të vështira përgatitore në rrethana të papara. Komisioni Këshillëdhënës rikujton se Raporti i UNMIK-ut nën Konventën Kornizë nuk është raporti i parë i përpiluar përbrenda instrumentit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut nga autoritetet aktuale të Kosovës, por poashtu është precedent i rëndësishëm në kontekstin e punës së përbashkët të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve në mbledhjen e informative dhe në vlerësimin e situatës së të drejtave të pakicave.
11. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se Raporti pasues, i dorëzuar me ca muaj vonesë, ofron pasqyrë të detajuar dhe të dobishme të aspekteve kryesore të kornizës legislative dhe përmban shtojca gjithëpërfshirëse me deklarata zyrtare dhe dokumente për çështje të pakicave. Sidoqoftë, cilësia dhe thellësia e Raportit është jo e njëjlojtë dhe përmban vetëm informata të limituara mbi praktikën në disa fusha kyçe të mbrojtjes së pakicave të Kosovës e tanishme. Për më tepër, Raporti poashtu ka edhe disa mospërputhje, duke ofruar, për shembull, në disa raste, edhe vlerësime pozitive si dhe negative të së njëjtës çështje. Këto mangësi duket të jenë, së paku pjesërisht, pasojë e procedurës specifike të përpilimit, gjatë së cilës organet e ndryshme të UNMIK-ut dhe ministritë e IPVQ-ve ofruan elemente të ndryshme për Raport, dhe si duket nuk janë bërë përpjekje për t’i përmirësuar këto mospërputhje në mes të elementeve të dhëna.
12. Duke kuptuar vështirësitë në përpilimin e raportit nën rrethana specifike që mbizotërojnë në Kosovë, dhe përvojën e kufizuar të disa organeve të IPVQ-ve të përfshira në proces, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se organet e UNMIK-ut përgjegjëse për versionin final të është dashur ta bëjnë të qartë se pikëpamjet e kujt paraqiten në segmentet e ndryshme të Raportit. Poashtu duket se kontributi i IPVQ-ve është kërkuar nga UNMIK-u në një fazë relativisht të vonshme të procesit, që ka çuar deri te afate të shkurta kohore për dorëzimin e kontributeve të tyre. Për më tepër, Komisioni Këshillëdhënës është i mendimit se konsultime më të gjera me organizata të pakicave kombëtare dhe përfaqësuesve të tjerë të shoqërisë civile do të kontribuonte në

cilësinë e Raportit dhe në të njëjtën kohë do të zhvillonte kapacitetin e aktorëve të shoqërisë civile dhe vetëdijesimin e tyre për Konventën Kornizë.

13. Komisioni Këshillëdhënës ka pranuar informata plotësuese të vlefshme përmes “raportit në hije” mbi implementimin e Konventës Kornizë në Kosovë, përpiluar nga grupe punuese të përbëra nga përfaqësues të komuniteteve pakicë dhe dorëzuar Komisionit Këshillëdhënës në shtator 2005. Komisioni Këshillëdhënës lavdëron punën e bërë nga ky grup punues multietnik dhe shpreson se IPVQ-të dhe të tjerët do të bazohen në ekspertizën e këtij grupi në përpjekjet e tyre për të përmirësuar implementimin e Konventës Kornizë në Kosovë.
14. Njohuria e Komisionit Këshillëdhënës për situatën e pakicave është përmirësuar dukshëm me vizitën e lartpërmendur në Kosovë. Gjatë vizitës, Komisioni Këshillëdhënës ka zhvilluar takime jo vetëm në Prishtinë por edhe në Fushë Kosovë, Dragash, Graçanicë, Mitrovicë dhe Prizren.
15. Vizita ofroi mundësi të shkëlqyeshme për të pasur dialog të drejtpërdrejtë me të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë përfaqësuesit e IPVQ-ve, anëtarët e Kuvendit të Kosovës, autoritetet lokale, komunitetet pakica, Ombudspersonin, dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Takimet me përfaqësuesit e UNMIK-ut, më saktësisht me ata që punojnë në Shtyllën II dhe III, Zyrën e Këshilltarit Ligjor dhe Zyrën e Komuniteteve, Kthimeve dhe Çështjeve të Pakicave ishin poashtu mjaft të dobishme. Në të njëjtën kohë, Komisioni Këshillëdhënës ndjen keqardhje që nuk u përfaqësuan të gjithë sektorët përkatës përmes bashkëbiseduesve të zgjedhur nga UNMIK-u në takime me Komisionin Këshillëdhënës. Kjo mund të pasqyrojë vetëdijesim të kufizuar mbi Konventën Kornizë në disa pjesë të strukturave të UNMIK-ut dhe fakti se rëndësia dhe lidhjet e mbrojtjes së pakicave me varg të gjerë sektorësh nuk njihet gjithmonë. Komisioni Këshillëdhënës, për shembull, do të kishte mirëpritur dialog më të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e Shtyllës I të UNMIK-ut (që ka të bëjë me Polici dhe Drejtësi). Komisioni Këshillëdhënës është i vetëdijshëm se vizita përkoji me procesin e reformimit në UNMIK që ndoshta ka pasur ndikim në kapacitetin e disa sektorëve përkatës të administratës të ofrojnë kontribut në procesin e monitorimit.

### **Përgjegjësitë për implementimin e Konventës Kornizë**

16. Situata aktuale në Kosovë në shumë aspekte është *sui generis*, dhe ky është rasti edhe për sa i përket përgjegjësisë për implementimin e Konventës Kornizë. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-së e datës 10 qershor 1999, përderisa njeh sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë dhe Malit të Zi, ajo themelon autoritetin e UNMIK-ut si një prani ndërkombëtare civile për të mundësuar një administratë të përkohshme për Kosovën. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së (PSSP) është i besuar me jashtëzakonisht të drejta të mëdha, duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë. Kjo do të thotë se, në rrethanat e tanishme, PSSP-ja, dhe UNMIK-u më përgjithësisht, janë në pozitë kyçe sa i përket sigurimit se ndërmerren masa adekuate për të implementuar Konventën Kornizë. Në të njëjtën kohë, një numër i përgjegjësive në rritje ju janë bartur IPVQ-ve në sferën e arsimit, kulturës dhe fushave

- të tjera që janë drejtpërdrejtë të lidhura me implementimin e Konventës Kornizë. Në rrethana të tilla, është e qartë se implementimi i Konventës Kornizë dhe përcjellja me rekomandime nga procesi aktual i monitorimit kërkojnë kontribut aktiv si nga institucionet ndërkombëtare ashtu edhe nga ato vendore.
17. Në të njëjtën kohë, Komisioni Këshillëdhënës ka përshtypjen se disa shqetësime të anëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë janë duke u rritur nga pasiguria mbizotëruese e fluksit lidhur me përgjegjësitë institucionale sa i përket implementimit të Konventës Kornizë. Kjo, në disa raste, ka rezultuar në një situatë ku përgjegjësitë nuk merren në mënyrë të qartë nga të gjitha autoritetet e përfshira, e individët e kanë vështirë ta identifikojnë një bashkëbisedues i cili do t'i adresonte shqetësimet e tyre legjitime. Komisioni Këshillëdhënës ka vërejtur tendenca të tilla, për shembull, në kontekstin e kthimit të personave që i përkasin komuniteteve pakicë.
18. Në këtë respekt, duke njohur nevojën e delegimit të detyrave tek institucionet e Kosovës dhe të zhvillohet pronësia vendore e iniciativave lidhur me pakica (shih paragrafin 22 më poshtë), Komisioni Këshillëdhënës e sheh të domosdoshme që UNMIK-u plotësisht t'i merr përgjegjësitë e veta dhe të ndërmer hapa të vendosur aty ku autoritetet vendore janë dëshmuar të jenë ende të papërgatitura t'i përmbushin obligimet e tyre në fusha të caktuara. Njëmend është e rëndësishme të rikujtohet se, sipas Kreut 8 të Kornizës Kushtetuese, pushteti dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në përfshijnë "Autoritet të plotë për të siguruar se të drejtat dhe interesat e Komuniteteve mbrohen plotësisht". Është e rëndësishme që nevoja për caktimin e vijave të qarta të përgjegjësisë dhe kompetencave mbi çështjet e pakicave të kihet parasysh gjatë bisedimeve për status së bashku me faktin se masat e ndërmarra në sektorë të ndryshëm nga ai i arsimit deri to zbatimi i ligjit, ndikojnë në implementimin e të drejtave të pakicave.
19. Faktor tjetër ndikues në përgjegjësitë për implementimin e parimeve të Konventës Kornizë është prania e "strukturave paralele" në Kosovë. Në kohën kur Komisioni Këshillëdhënës përpiloi opinionin e vet të parë për Serbinë dhe Malin e Zi më 2003, theksoi se nuk ka mundur ta ekzaminojë situatën në Kosovë në hollësi, duke qenë se Kosova ishte jashtë kontrollit efektiv të Palës Shtetërore<sup>2</sup> në pyetje. Komisioni Këshillëdhënës, thekson, sidoqoftë në këtë kontekst se strukturat paralele vazhdojnë së funksionuari në Kosovë në vendet e banuara me serbë duke ofruar arsim dhe shërbime tjera serbëve dhe një numri personash nga pakicat tjera, kryesisht romëve. Pasi që këto struktura në masë të madhe financohen dhe udhëhiqen nga autoritetet e Beogradit, këto autoritete poashtu ndikojnë, *de facto*, në mënyrën se si konsiderohen standardet e Konventës Kornizë në vende të ndryshme të Kosovës.

### **Trashëgimia e së kaluarës së vonshme**

20. Komisioni Këshillëdhënës thekson se trashëgimia negative e regjimit të Milosheviqit ende ndjehet thellë në Kosovë sidomos në mesin e shqiptarëve të Kosovës të cilët ishin viktimat kryesore të politikave dhe praktikave të regjimit të lartpërmendur. Në të njëjtën

<sup>2</sup> Komisioni Këshillëdhënës mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni mbi Serbinë e Malin e Zi ACFC/INF/OP/I(2004)002.

kohë, komunitetet tjera në Kosovë, kryesisht serbët dhe romët, ende preken nga akte të dhunës, në veçanti me shpërngulje të madhe dhe shkatërrim të shtëpive pas intervenimit të NATO-s më 1999 dhe shpërthimit të dhunës anembanë Kosovës në mars të vitit 2004. Zhvillimet tjera edhe më tej kanë dëmtuar marrëdhëniet dhe besimin ndëretnik. Kjo trashëgimi e ndërlikon detyrën e autoriteteve aktuale për të implementuar Konventën Kornizë dhe bën të domosdoshme ndërmarrjen e masave konkrete për ndërtimin e tolerancës ndëretnike dhe barazisë efektive. Kjo do të paraqiste sfida të madhe për cilëndo administratë, e lere më për institucionet e Kosovës që ende janë në fillimin të marrjes së përgjegjësive në këtë lëmi dhe në shumë raste ende duhet ta fitojnë besimin e komuniteteve pakicë.

21. Përderisa është e kuptueshme se përmirësimi i marrëdhënieve në mes të serbëve dhe shqiptarëve shihet si sfida më e madhe në Kosovën e sotme, ekziston rreziku se situatës së komuniteteve tjera pakicë në Kosovë nuk ju ofrohet vëmendja e duhur nga UNMIK-u, IPVQ-të dhe të aktorëve tjerë, përkundër disa garancive të rëndësishme, si ulëset e rezervuara për komunitetet pakicë në Kuvendin e Kosovës. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se është e rëndësishme kyçe që këto komunitete të përfshihen në disenjimin, implementimin dhe vlerësimin e politikave, praktikave dhe legjislacionit që në mënyrë direkte apo indirekte lidhet me komunitetet pakicë. Kjo poashtu ka të bëjë me bisedimet rreth statusit të ardhshëm të Kosovës, ku përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve pakicë duhet të kenë rol domethënës përtej atij të konsultimit *pro forma*, në mënyrë që të sigurohet se rezultati do të merr parasysh edhe shqetësimet e tyre. Kjo do të ndihmonte në sigurimin se vendimet rezultuese janë plotësisht në pajtim me Konventën Kornizë për sa iu përket të gjitha komuniteteve përkatëse.
22. Në të njëjtën kohë, Komisioni Këshillëdhënës është në dijeni se implementimi i legjislacionit, politikave dhe praktikave është vështirë të kenë sukses përderisa të fundit konsiderohen si të “imponuara” nga jashtë dhe nuk përkrahen nga masa e madhe e popullatës së përgjithshme. Ky rrezik është posaçërisht i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së pakicave, ku, përderisa shpeshherë është vështirë të arrihet konsensus, është thelbësore që legjislacioni i ri të gjejë përkrahje sa më të gjerë që të jetë e mundur, si në nivelin vendor ashtu edhe jashtë arenës politike. Njëmend, Komisioni Këshillëdhënës e ka përshtypjen se prezantimi i disa standardeve lidhur me pakicat, duke përfshirë Konventën Kornizë, por edhe legjislacioni si Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë, nuk është shoqëruar me informata adekuate dhe ngritje të vetëdijes dhe se dijenia e kufizuar dhe mbështetja e tyre është një nga arsyet pse dispozitat e rëndësishme në pyetje rrallëherë deri më tani janë sfiduar.

### III. KOMENTE SPECIFIKE LIDHUR ME NENET 1-19

#### Neni 1

23. Komisioni Këshillëdhënës është mirënjohës ndaj faktit se Korniza Kushtetuese mundëson aplikueshmëri direkte të një numri instrumentesh ndërkombëtare të së drejtave të njeriut lidhur me pakicat kombëtare, duke përfshirë edhe Konventën Kornizë. Duke pasur parasysh situatën specifike ligjore në Kosovë, mekanizmat ndërkombëtarë monitorues të këtyre traktateve nuk kanë funksionuar efektivisht deri më tani në Kosovën e administruar nga UNMIK-u dhe kjo ka ngritur disa pyetje legjitime rreth përgjegjësisë së autoriteteve të vendosura në Kosovë. Procesi aktual i monitorimit është hap i rëndësishëm në adresimin e këtyre pyetjeve dhe Komisioni Këshillëdhënës e sheh të rëndësishme që të ndërmerren iniciativa të ngjashme në lidhje me traktatet tjera përkatëse, edhe pse është e qartë se secila prej tyre përfshin çështje specifike ligjore dhe institucionale që duhet të adresohen. Në këtë kontekst, Komisioni Këshillëdhënës me kënaqësi mësoi se UNMIK-u planifikon të raportojë për implementimin e Konventës Ndërkombëtare të së Drejtave Civile dhe Politike dhe Konventës Ndërkombëtare të së Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore tek organet përkatëse të KB-së.
24. Komisioni Këshillëdhënës e sheh si thelbësore që kjo çështje të adresohet në bisedimet lidhur me statusin e Kosovës në mënyrë që të sigurohet jo vetëm implementimi dhe vazhdimi i procesit monitorues së Konventës Kornizë në Kosovë, por edhe të shtohet implementimi dhe monitorimi i traktateve tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me çështje të prekin mbrojtjen e pakicave kombëtare.

#### Neni 2

25. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se implementimi i parimeve në këtë nen janë të një rëndësie të veçantë në Kosovë ku institucionet vendore me përvojë dhe ekspertizë të kufizuar duhet ta dëshmojnë vendosmërinë e tyre për të implementuar dispozitat e Konventës Kornizë me përkushtim në mënyrë që të ndërtojnë besimin në mes të komuniteteve të ndryshme pas disa kthimeve serioze prapa, si ngjarjet e marsit 2004.

#### Neni 3

##### Shtrirja e aplikimit të Konventës Kornizë

26. Termi “pakicë kombëtare” *per se* nuk përdoret rregullisht në legjislacionin apo në praktikën e Kosovës, pasi që termi i preferuar duket të jetë “komunitete”.<sup>3</sup> Në të njëjtën kohë, ka pajtim të gjerë se komunitetet joshqiptare të Kosovës mbulohen nga Konventa

<sup>3</sup> Raporti i UNMIK-ut thotë me sa vijon: “Korniza Kushtetuese dhe ligjet e Kosovës nuk e përdorin termin "pakicë kombëtare" por "Komunitete", që përshkruan banorët që i takojnë grupit të njejtë etnik, fetar apo gjuhësor. "Komunitetet" në Kosovë kryesisht përfshijnë shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës, turqit, boshnjakët, goranët, torbeshët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe kroatët e Kosovës.”

Kornizë dhe ky pozicion pasqyrohet edhe në Raportin e UNMIK-ut. Komisioni Këshillëdhënës e mirëprët këtë qasje pragmatike dhe pajtohet se aplikueshmëria e Konventës Kornizë nuk nënkupton domosdoshmërisht se termi “pakicë kombëtare” duhet të përdoret në legjislacionin, politikat apo praktikat përkatëse për të emëruar grupet në pyetje.

27. Sidoqoftë, ka mospajtime dhe mospërputhje të ndryshme lidhur me miratimin e identitetit specifik të komuniteteve konkrete. Kjo vlen në veçanti për komunitetin egjiptas i cili shpesh trajtohet nga autoritetet si/ose pjesë e komunitetit rom apo ashkali. Ngjashëm, ashkalinjtë shpesh trajtohen së bashku me romët, gjë që nuk pasqyron praktikën vetidentifikuese në mesin e ashkalinjëve. Përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare shpesh ju referohen grupeve të lartpërmendura si “komunitetet RAE”. Duke kuptuar se ky term është krijuar vetëm për shkaqe praktike, për ta lehtësuar referimin, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se një formulim i tillë duhet të shmanget pasi që mund të shihet si mungesë e pranimit të identiteteve specifike të grupeve në pyetje.

### **Regjistrimi i popullatës dhe amvisërive dhe mbledhja e të dhënave**

28. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se një nga iniciativat kryesore lidhur me implementimin e Konventës Kornizë është regjistrimi i planifikuar i popullatës dhe amvisërive. Regjistrimi testues është organizuar në disa komuna të zgjedhura prej 31 tetorit deri më 15 nëntor 2005<sup>4</sup>, me plan që regjistrimi i plotë të bëhet në vitin 2006.
29. Komisioni Këshillëdhënës pajtohet me nevojën e kryerjes së regjistrimit në Kosovë dhe në përmirësimin e statistikave poashtu edhe në aspektin e përbërjes etnike të popullatës. Të dhënat ekzistuese janë të kualitetit të dobët. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1991 ishin jo të plota çysh në kohën e publikimit të tyre, kryesisht për shkak të pjesëmarrjes së kufizuar dhe që nga atëherë, situata në Kosovë, duke përfshirë edhe përbërjen etnike të popullatës, natyrisht ka pësuar ndryshime drastike. Mungesa e të dhënave të besueshme e bën të vështirë përgatitjen dhe implementimin e politikave, programeve dhe legjislacionit për pakica. Të dhënat e tilla janë të domosdoshme, për shembull, në mënyrë që të përpilohen dhe zhvillohen masa efektive dhe adekuate për të siguruar pjesëmarrje efektive të personave nga radhët e pakicave kombëtare në organe publike apo për të siguruar mbështetjen e duhur për gjuhët dhe kulturat e pakicave në arsim dhe në fusha tjera. Informatat e plotësuara statistikore poashtu janë parakusht për implementim efikas dhe objektiv të ligjit të paraparë për gjuhë, i cili në formën e tashme përmban kufi numerik për aplikueshmërinë e shumë prej dispozitave kyçe të veta.
30. Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret faktin se autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e regjistrimit të popullatës dhe amvisërive janë të vetëdijshme për nevojën që të marrin parasysh disa parime kyçe të Nenit 3 të Konventës Kornizë, duke përfshirë të drejtën për t’u trajtuar apo mos u trajtuar si person që i përket një pakice kombëtare, e drejtë që poashtu garantohet me Kornizën Kushtetuese. Për shembull, përderisa Ligji mbi

<sup>4</sup> Regjistrimi testues u zhvillua nga 31 tetori dhe 15 nëntori në gjashtë komuna të Kosovës. Në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Kaçanik, Novobërdë dhe Skenderaj.

- Regjistrimin e Popullatës dhe Amvisërive në Kosovë, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe shpallur nga PSSP-ja më 13 dhjetor 2004, fatkeqësisht është me shumëkuptimësi, formularët e përgatitur para regjistrimit testues, si dhe doracaku shpjegues i lëshuar më 31 tetor 2005, në mënyrë të qarët theksojnë se individët nuk janë të obliguar për t'u përgjigjur në pyetjet lidhur me kombësinë/etnicitetin e tyre apo edhe përkatësinë fetare.
31. Sidoqoftë, ka rreziqe të shoqëruara me organizimin e regjistrimit në rrethanat aktuale në Kosovë. Përveç problemeve me kapacitet të identifikuar në Zyrën Statistikore të Kosovës (ZSK), që është përgjegjëse për mbledhjen, procedimin dhe distribuimin e të dhënave statistikore, dhe mangësive me garancitë themelore lidhur me ruajtjen e të dhënave, procesi i regjistrimit do të ballafaqohet me probleme serioze të legjitimitetit nëse nuk siguron pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve të Kosovës, duke përfshirë serbët, romët dhe komunitetet tjera pakicë. Aktualisht, ka mosmarrëveshje lidhur me disa aspekte të rëndësishme të procesit, më saktësisht se a do të përfshihen në procesin e regjistrimit personat e zhvendosur përbrenda dhe të tjerët të cilët kanë qëndruar jashtë Kosovës për më gjatë se 12 muaj. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se kjo çështje kërkon shqyrtim të kujdesshëm dhe se pikëpamjet e përfaqësuesve të komuniteteve pakicë duhet të merren parasysh në këtë kontekst. Duke qenë të vetëdijshëm për problemet e ndryshme teknike, metodologjike dhe të tjera, Komisioni Këshillëdhënës është i mendimit se autoritetet duhet të gjejnë mënyra për të përfshirë në proces të definimit të statistikave më të sakta edhe personat e zhvendosur që kanë shprehur dëshirën për t'u kthyer.
  32. Komisioni Këshillëdhënës mendon se zbatimi i regjistrimit pa perspektivë të pjesëmarrjes së gjerë përbrenda të gjitha komuniteteve dhe pa mbështetje në mesin e komuniteteve pakicë mund të ketë pasoja negative jo vetëm sa i përket kualitetit të statistikave të mbledhura por edhe implementimit të parimeve të ndryshme të Konventës Kornizë. Duket se një besim dhe mbështetje e tillë për procesin duhet të forcohet edhe më tej, gjë që është vërejtur edhe nga fakti se planet për ta kryer regjistrimin testues në tetor – nëntor 2005 edhe në komunën e Leposaviqit me shumicë serbe nuk arritën të implementohen.
  33. Në dritën paraprake, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se më shumë kohë se ajo e paraparë nga autoritetet nevojitet për përgatitjen e regjistrimit të plotë dhe thekson se shtyrja e procesit të regjistrimit ishte një nga rekomandimet e ekspertëve të Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara, të cilët zbatuan misionin ndërkombëtar të monitorimit të regjistrimit në Kosovë më 17-20 tetor 2005.
  34. Komisioni Këshillëdhënës thekson se, në Kosovë, të dhënat mbi përkatësinë e komunitetit të individëve poashtu mblidhen edhe në kontekste të tjera, duke filluar nga arsimi deri të punësimi, si dhe në nivelin komunal. Duke u pajtuar se ekziston nevoja për sigurimin e të dhënave cilësore në këto fusha, Komisioni Këshillëdhënës thekson se mbledhja e të dhënave mbi përkatësinë kombëtare të individëve duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse adekuate, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të dhënave personale. Pasi që rëndësia e mbrojtjes së të dhënave ende nuk ka fituar vëmendje adekuate në Kosovë, Komisioni Këshillëdhënës do të nënvizonte parimet e identifikuara në Rekomandimet e

Komitetit të Ministrave (97) 18 lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura dhe proceduara për çështje statistikore. Poashtu është e rëndësishme të sigurohet se e drejta e mostrajimit të një personi si anëtar i një pakice kombëtare është e mbrojtur dhe se personat në pyetje të informohen në mënyrë të vazhdueshme se ofrimi i të dhënave mbi përkatësinë kombëtare të një personi është çështje vullnetare, në përputhje me Kreun 4 të Kornizës Kushtetuese.

#### Neni 4

#### Legjislacioni Kundër Diskriminimit dhe mjetet ligjore

35. Komisioni Këshillëdhënës thekson me kënaqësi se autoritetet në Kosovë kanë prezantuar legjislacionin progresiv kundër diskriminimit, në veçanti përmes Ligjit Kundër Diskriminimit miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe shpallur nga PSSP-ja më 20 gusht 2004 (Rregullorja e UNMIK-ut No. 2004/32). Ligji i lartpërmendur ofron garanci të gjera kundër diskriminimit direkt dhe indirekt si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Ligji nuk prezanton ndonjë strukturë të re për ta luftuar diskriminimin etnik por ja beson Ombudspersonit dhe gjykatave detyrën e pranimit, respektivisht, hetimit të ankesave për diskriminim në pajtim me legjislacionin në fuqi.
36. Duke theksuar rëndësinë e pranisë së një legjislacioni të tillë që do të mbronte anëtarët e pakicave kombëtare nga diskriminimi, Komisioni Këshillëdhënës është posaçërisht i brengosur për probleme lidhur me implementimin në praktikë të një legjislacioni të tillë dhe rreth vazhdimit të pranisë së *de facto* diskriminimit të personave që ju përkasin komuniteteve pakicë në Kosovë. Problemet e tilla janë sidomos të pranishme te serbët dhe romët por duket se edhe anëtarët e komuniteteve tjera pakicë kanë probleme të caktuara në këtë kontekst.
37. Përkundër problemeve të lartpërmendura, Ligji Kundër Diskriminimit rrallëherë është sfiduar përpara gjyqësisë nga ana e anëtarëve pakicë. Kjo situatë ka mundur të jetë pjesërisht rezultat i mungesës së vetëdijesimit, por poashtu duket të ketë lidhshmëri me problemet serioze që kanë efekt negativ në qasjen në drejtësi në Kosovë, duke përfshirë, *inter alia*, mangësitë në disponueshmërinë e ndihmës juridike dhe ngarkesës me lëndë të pashqyrta. Përderisa shumë nga problemet kanë implikacione edhe për anëtarët e komunitetit shumicë, efektet e tyre janë posaçërisht serioze për personat e zhvendosur dhe ata të komuniteteve pakicë. Për më tepër, numri i personave nga radhët e komuniteteve pakicë të punësuar në strukturat gjyqësore, duke përfshirë në postet e gjykatësve apo nëpunësve tjerë, është joproportionalisht i ulët. Kjo e vështirëson ndërtimin e besimit të komuniteteve pakicë në sistemin gjyqësor. Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret faktin se problemet që prekin gjyqësinë pranohen haptas nga ana e autoriteteve, duke përfshirë Raportin e UNMIK-ut, dhe një numër iniciativash të rëndësishme janë lansuar për t'i trajtuar këto probleme, edhe pse duket se implementimi i tyre ka hasur në pengesa të ndryshme dhe ka arritur vetëm rezultate të prekshme të kufizuara.

38. Në rrethana të tilla, Zyra e Ombudspersonit shpeshherë është opsioni më i afërt për viktimat e diskriminimit dhe kjo Zyre me të vërtetë është bërë institucion kyç dhe i besuar për personat që ju takojnë komuniteteve pakicë, jo vetëm për rastet e diskriminimit or edhe sa i përket implementimit të të drejtave të tyre në përgjithësi. Një element i rëndësishëm i punës së Ombudspersonit ka qenë edhe aftësia e tij për të ngritur çështje edhe pranë autoriteteve ndërkombëtare që shpesh janë në mundësi të ndërmarrin masa për t'i adresuar dhe identifikuar mangësitë.
39. Në këtë situatë, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se është e parakohshme, në këtë fazë, të zbatohet bartja e planifikuar e institucionit të Ombudspersonit, që aktualisht është nën udhëheqjen ndërkombëtare, tek një institucion plotësisht vendor. Komisioni Këshillëdhënës është i mendimit se një bartje e tillë nuk do të duhej të bëhej para se të vlerësohej sigurt se Ombudspersoni mund të funksionojë efektivisht si një institucion vendor, pa dëmtuar besimin e ndërtuar deri më tash në mesin e komuniteteve pakicë.

### **Liria e lëvizjes**

40. Liria e lëvizjes nuk garantohet qartas në Konventën Kornizë, por ky parim nënkuptohet në garancitë e përfshira në Nenin 4 të Konventës Kornizë, siç është cekur në Raportin Shpjegues të Konventës Kornizë. Rëndësia e lirisë së lëvizjes me të drejtë theksohet në Planin e Zbatimit të Standardeve për Kosovën të 6 korrikut 2004, që përmban disa zotime të rëndësishme në këtë drejtim. Kjo është një fushë ku personat që ju takojnë komuniteteve pakicë vazhdojnë të hasin në probleme serioze duke filluar nga rastet e diskriminimit, armiqësisë ndëretnike dhe faktorëve të tjerë. Ka pasur disa përmirësime lokale në këtë drejtim në fusha të caktuara, por situatë e përgjithshme mbetet brengosëse duke përfshirë kështu një numër të madh personash që nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre si dhe pengesa serioze në qasjen e shërbimeve të ndryshme, nga ai shëndetësor deri te gjykatat dhe transporti publik.
41. Përderisa disa komentatorë kanë pohuar se problemet e lirisë së lëvizjes janë kryesisht të vetimponuara dhe të shkaktuara nga dezinformimi që e ekzagjeron shkallën e seriozitetit të problemit, Komisioni Këshillëdhënës nuk e ndan këtë mendim. Përvoja e fundit e individëve në pyetje, duke përfshirë rastet e dhunës së marsit 2004, kuptueshëm e kanë bërë të vështirë, pothuajse të pamundur, për shumë persona të besojnë se progresi i arritur në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike është i qëndrueshëm. Besimi në qëndrueshmërinë e progresit poashtu dëmtohet nga rastet e rregullta të keqtrajtimit dhe incidenteve tjera të drejtuara kundër disa komuniteteve të caktuara pakicë si dhe nga perceptimi se ekziston shkallë e lartë e mosndëshkimit të krimin të motivuar etnikisht (shih edhe komentet nën Nenin 6). Autoritetet duhet ta pranojnë përgjegjësinë e tyre për të ndërmarrë masa më proaktive. Në të njëjtën kohë, Komisioni Këshillëdhënës pajtohet se mediat si në Kosovë ashtu edhe në vendet e rajonit kanë rol sensitiv në raportimin mbi këtë fushë.

### Procesi i kthimit dhe barazia e plotë dhe efektive

42. Komisioni Këshillëdhënës konstaton se barazia e plotë dhe efektive për personat që ju përkasin komuniteteve pakicë është në shumë lëmi ende larg arritjes në Kosovë. Ekziston nevoja për ndërmarrjen e masave të mëtejme pozitive për shembull në fushën e punësimit, duke u bazuar, *inter alia*, në përvojat që janë fituar gjatë implementimit të fushatës për punësimin e anëtarëve të komuniteteve pakicë, iniciuar nga Qeveria e Kosovës në janar 2005. Edhe pse Komisioni Këshillëdhënës është i vetëdijshëm se situata e përgjithshme ekonomike në Kosovë është shumë e vështirë dhe se shkalla e papunësisë është poashtu tejet e lartë edhe në mesin e shqiptarëve të Kosovës, personat nga komunitetet pakicë si goranët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe serbët e zhvendosur janë në situatë posaçërisht të vështirë në këtë aspekt (shih edhe komentet nën Nenin 15).
43. Komisioni Këshillëdhënës rikujton se kjo çështje është poashtu e lidhur me procesin e kthimit, pasi që kthimi kërkon jo vetëm siguri por edhe mundësi punësimi. Duke pasur parasysh se kryesisht popullata rurale e ka shqyrtuar kthimin, është me rëndësi të sigurohet riposedimi dhe qasja në tokën e tyre bujqësore. Sa i përket procesit të kthimit në vija më të përgjithshme, Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se kjo konsiderohet si çështje prioritare nga autoritetet dhe se është element kyç i planit të zbatimit të standardeve. Në të njëjtën kohë, Komisioni Këshillëdhënës e sheh të rëndësishme që liria e zgjedhjes së vendbanimit nga ana e personave në pyetje të merret parasysh në këtë proces dhe që përgatitja dhe zbatimi i masave ndihmëse të jenë aq fleksibile në mënyrë që të përputhen me faktin se jo që të gjithë personat e shohin të rrugës të kthehen mu në vendin ku kanë banuar më herët, për shkaqe objektive dhe subjektive, duke filluar nga shqetësimet për siguri deri te perspektiva e kufizuar për punësim.
44. Përkundër përpjekjeve të ndryshme për ta lehtësuar procesin e kthimit, Komisioni Këshillëdhënës është i brengosur se një çështje ende nuk ka marrë vëmendjen e duhur në këtë kontekst e kjo është situata me ashkali dhe me personat e komuniteteve tjera pakicë që me forcë janë kthyer në Kosovë nga Evropa perëndimore dhe të cilët nuk kanë qasje në skemat e asistencës nga të cilat përfitojnë personat e kthyer vullnetarisht. Përderisa është përtej fushëveprimit të Opinionit aktual të komentojë mbi arsyeshmërinë e zbatimit të kthimeve me dhunë në Kosovë në rrethanat e tanishme, Komisioni Këshillëdhënës shpreh keqardhje se as UNMIK-u e as IPVQ-të nuk kanë ofruar asistencë sistematike apo masa tjera për të ndihmuar integrimin e individëve që janë kthyer me dhunë (shih edhe komentet në paragrafin 17 mbi problemet e shkaktuara nga mungesa e qartësisë sa i përket ndarjes së përgjegjësisë). Sido që të jetë, këta persona janë shpesh në nevojë serioze për një mbështetje, asistencë dhe udhëzim të tillë, duke pasur parasysh se një numër i tyre kanë jetuar jashtë vendit me vite të tëra dhe nuk kanë lidhje të forta me komunat në të cilat janë kthyer. Janë propozuar një numër iniciativash për përmirësimin e situatës, si për shembull nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), duket se nuk ka mbështetje të duhur financiare për ta adresuar këtë çështje të rëndësishme që është drejtpërdrejtë e lidhur me barazinë e plotë dhe efektive të personave në pyetje.

## Romët

45. Komisioni Këshillëdhënës konstaton se romët janë në situatë posaçërisht të vështirë në Kosovë, kështu që kërkohet një qasje më strategjike që do të merrej me problemet e tyre. Problemet e tyre serioze ekonomike dhe sociale në banim, arsim dhe punësim bëhen edhe më të shprehura nga diskriminimi me të cilin ballafaqohen si dhe nga ndjenjat antirome që shpeshherë vërehen te komuniteti shumicë, kështu duke pasur lëvizje të kufizuar dhe duke ndikuar tek ushtrimi i të drejtave tjera të tyre. Romët dhe prona e tyre poashtu kanë qenë cak i dhunës ndëretnike para dhe pas ngjarjeve të marsit 2004, dhe aktualisht qasja e tyre në pronë në shumë raste pengohet seriozisht nga mungesa e dokumentimit adekuat.
46. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se, pas viteve të mosveprimit, problemet e romëve kanë fituar vëmendje nga qarqet ndërkombëtare dhe autoritetet vendore. Ky është në veçanti rasti me situatën alarmante në kampet e romëve në pjesën veriore të Mitrovicës të kontrolluar nga serbët dhe në Zveçan. Shumica e romëve kanë jetuar nëpër këto kampe prej shkatërrimit të lagjes së tyre në pjesën jugore të lumit Ibër në Mitrovicë ku më 1999 jetonin diku rreth 8,000 romë, ashkali dhe egjiptas. Përpos jetesës në kushte përgjithësisht jashtë çdo standardi banimi, banorët e këtyre kampeve, që gjenden afër minierës së Trepçës dhe deponive të saj, janë të ekspozuar, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), ndaj niveleve jashtëzakonisht të larta të plumbit. Kjo situatë, që përbën rrezik serioz shëndetësor posaçërisht për fëmijë dhe gra shtatzëna, nuk është në pajtim me parimet e Nenit 4 të Konventës Kornizë dhe kërkon masa urgjente dhe konkrete.
47. Vonesat serioze në adresimin e kësaj çështje – që vetëm tash pas vëmendjes së gjerë ndërkombëtare, konsiderohet prioritet i lartë nga ana e UNMIK-ut dhe autoriteteve tjera në Kosovë – kanë dëmtuar përpjekjet e deritashme për të ndërmarrë veprim të vendosur dhe kanë bërë të vështirë fitimin e besimit dhe mbështetjes së romëve ndaj masave të parapara. Plani aktual i autoriteteve të Kosovës për të zhvendosur romët në një vend të përkohshëm deri t'ju ndërtohen shtëpitë e reja në lagjen në pjesën jugore të lumit Ibër në Mitrovicë. Udhëheqësit romë në kampe kanë shprehur kundërshtim ndaj planeve të zhvendosjes së përkohshme, duke shprehur brengë se ky vendbanim i përkohshëm mund të shndërrohet në banim të përhershëm. Brengat e tilla intensifikohen edhe më tej nga mbështetja e kufizuar financiare prej donatorëve dhe mungesa e orarit real për ndërtimin e Lagjes.
48. Komisioni Këshillëdhënës e konsideron urgjente shmangien e politizimit të këtij problemi humanitar dhe i të drejtave të njeriut dhe se mirëqenia dhe shëndeti i romëve të jetë konsiderata themelore nga të gjitha palët relevante. Përfundimisht, Komisioni Këshillëdhënës thekson se autoritetet duhet të jenë vigjilente në sigurimin që procesi aktual i rihapjes së një numri minierash në Kosovë të shoqërohet me standarde gjithëpërfshirëse të ambientit që do të zbatoheshin në mënyrë strikte për t'u siguruar se komunitetet pakicë dhe të tjerët nuk janë të ekspozuar ndaj problemeve të ngjashme në të ardhmen.

## Neni 5

49. Plani i Zbatimit të Standardeve për Kosovën me të drejtë thekson rëndësinë e kontributit të të gjitha komuniteteve në trashëgiminë kulturore të Kosovës. Komisioni Këshillëdhënës thekson se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka mandatin që të promovojë aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore dhe lidhjet me anëtarët e të gjitha komuniteteve etnike, religjioze dhe gjuhësore. Raporti i UNMIK-ut përmban një listë projektesh themelore të iniciuara nga komunitetet pakicë dhe të mbështetura nga ministria e lartpërmendur, edhe pse shumë prej tyre duket të lidhen me sportin në përgjithësi dhe me aktivitete tjera të komuniteteve pakicë që nuk synojnë promovimin e kulturave të pakicave si të tilla.
50. Është vështirë të vlerësohet zhvillimi i nivelit të mbështetjes së ofruar ndaj kulturave të pakicave në Kosovë gjatë viteve të fundit, edhe duke lënë anash situatën e serbëve, që ka pësuar ndryshime drastike dhe që poashtu është prekur nga prania e strukturave paralele. Informatat e pranura nga Komisioni Këshillëdhënës tregojnë, sidoqoftë, se një mbështetje e tillë është tejet e kufizuar dhe, sipas disa komuniteteve pakicë, përpjekjet për ta mbështetur dhe promovuar kulturën e tyre janë zvogëluar me kalimin e viteve. Shqetësimet e tilla i janë bërë me dije Komisionit Këshillëdhënës për shembull nga ana e anëtarëve të komunitetit turk, të cilët duke folur për problemet me të cilat ballafaqohen, *inter alia*, në ruajtjen e institucioneve kulturore në fushën e teatrit dhe muzikës. Disa komunitete tjera, duke përfshirë anëtarët e komunitetit ashkali dhe egjiptas, poashtu konsiderojnë se nuk janë pranues të mbështetjes adekuate për mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të tyre kulturor. Promovimi i kulturave të minoriteteve poashtu ka pësuar nga fakti se shumë personalitete të shquara, duke përfshirë ata nga radhët e romëve, e kanë lëshuar Kosovën.
51. Duke marrë parasysh komentet e më sipërme lidhur me ndarjen e mbështetjes për iniciativat kulturore të komuniteteve pakicë, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se përfshirja e përfaqësuesve të pakicave kombëtare në procesin e vendimmarrjes është kyç në mënyrë që të sigurohet se resurset e kufizuara të distribuohen në mënyrë optimale. Komisioni Këshillëdhënës inkurajon autoritetet që të shqyrtojnë se a është sistemi aktual, i përmendur në Raportin e UNMIK-ut, i përfshirjes së dy ekspertëve nga komunitetet pakicë në Bordin përgjegjës për zgjedhjen e projekteve për t'u financuar, i mjaftueshëm për të siguruar një përfshirje të tillë.
52. Në implementimin e parimeve të Nenit 5 të Konventës Kornizë në Kosovë, një sfidë të veçantë përbën fakti se objektet kulturore dhe të tjera që përfaqësojnë komunitetin serb dhe Kishën Ortodokse Serbe në disa raste kanë qenë cak i sulmeve në Kosovë. Rasti më shqetësues i kësaj është shkatërrimi i objekteve të rëndësishme ortodokse, duke përfshirë dëmin gjatë ngjarjeve të marsit 2004. Është inkurajuese se, pas disa vonesave, procesi i restaurimit të objekteve të dëmtuara tani është në zhvillim e sipër nën kujdesjen e Komisionit për Implementimin e Rindërtimit të Objekteve Ortodokse në Kosovë (RIC), të themeluar në maj 2005 nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian dhe UNMIK-u. Në të njëjtën kohë, incidente shqetësuese që përfshijnë objekte të tilla

janë raportuar kohëve të fundit, duke përfshirë vjedhjen e një pjese të kulmit të kishës Shën Premtja në Prizren më 2005.

## Neni 6

### Përpjekjet për ta luftuar armiqësinë ndëretnike

53. Komisioni Këshillëdhënës thekson se korniza normative për luftën kundër urrejtjes ndëretnike është zhvilluar në Kosovë, me rregullore specifike të UNMIK-ut mbi ndalimin e nxitjes së mospajtimit apo mostolerancës kombëtare, racore, religjioze apo etnike si dhe me norma tjera që ofrojnë garanci të rëndësishme në këtë drejtim. Sidoqoftë, ka një zbrastësi jashtëzakonisht të madhe në mes të normave dhe realitetit në këtë fushë. Sipas UNMIK-ut, dhuna gjithëpërfshirëse kundër anëtarëve të komuniteteve pakicë është në ulje tani në Kosovë. Komisioni Këshillëdhënës, sidoqoftë, thekson se një dhunë e tillë ndodhi në mars 2004 dhe se raste serioze të armiqësisë ndëretnike ende raportohen mjaft shpesh (mbi incidentet lidhur me objektet fetare, shih komentet në nenet 5 dhe 8). Për më tepër, është qëndrim mjaft i përhapur se një masë e madhe e manifestimeve ditore të armiqësisë dhe keqtrajtimeve ndëretnike nuk ju raportohen organeve për zbatimin e ligjit, shpesh për shkak të mungesës së besimit tek institucionet dhe tek efektiviteti i mjeteve ligjore në dispozicion.
54. Vlerësimi i zhvillimeve në këtë fushë është, sidoqoftë, shumë i vështirë për shkak të faktit se nuk ka të dhëna gjithëpërfshirëse mbi statusin e hetimeve dhe ndjekjeve penale të incidenteve etnike që nga viti 1999. Komisioni Këshillëdhënës është i mendimit se kjo është një mangësi serioze, sidomos në një shoqëri si Kosova, ku është vitale të dëshmohet, në mënyrë transparente, se si institucionet publike i trajtojnë incidentet ndëretnike dhe të sigurojnë se proceset e ndërlydhura janë objektive, të paanshme dhe korrekte. Komisioni Këshillëdhënës thërret Zyrën e UNMIK-ut për Komunitete, Kthime dhe Çështje të Pakicave si dhe autoritetet tjera relevante që të t'i ndjekin planet e tyre për të themeluar një bazë të të dhënave mbi këtë çështje si prioritet.
55. Është e qartë se përvojat e ngjarjeve të marsit 2004, gjatë së cilave Forca e Kosovës (KFOR), UNMIK-u dhe policia vendore nuk ishin në gjendje që në mënyrë efektive t'i mbrojnë anëtarët e komuniteteve pakicë, dëmtuan seriozisht besimin e këtyre të fundit tek organet për zbatimin e ligjit për t'u ballafaquar me dhunë ndëretnike. Fakti se një numër krimesh dhune kundër anëtarëve të komuniteteve pakicë vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura poashtu ka kontribuar në opinionin, të ndarë nga shumica e personave brenda komuniteteve pakicë, se ekziston shkallë e lartë e mosdëshkimit sa i përket krimit të motivuar etnikisht ndaj personave që ju takojnë komuniteteve pakicë. Komisioni Këshillëdhënës thekson se hetime dhe ndjekje penale energjike të krimeve ndëretnike, duke përfshirë sulmet e dhunës të marsit 2004, janë *sine qua non* për një progres të mirëfilltë në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë.
56. Përkundër problemeve të lartpërmendura, Komisioni Këshillëdhënës pranon se disa përpjekje serioze janë ndërmarrë në këtë drejtim, jo vetëm nga forcat ndërkombëtare por edhe nga Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), i cili synon ta ndërtojë kredibilitetin dhe

besimin te komunitetet pakicë. Është e qartë se rekrutimi i pjesëtarëve nga komunitetet pakicë, që është e një rëndësie kyçe jo vetëm në vendet e banuara nga komunitetet pakicë por edhe në vendbanime tjera, është një nga faktorët thelbësorë që ndikon në suksesin e ardhshëm të këtij institucioni. Në të njëjtën kohë, është poashtu thelbësore që KFOR-i dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë - të cilët mbeten elementët kryesorë në përpjekjet për ta përmirësuar sigurinë dhe lirinë e lëvizjes së personave nga komunitetet pakicë në vende të caktuara – ta mbajnë praninë e tyre për sa kohë të jetë e nevojshme dhe se pikëpamjet e përfaqësuesve të komuniteteve pakicë të merren parasysh në procesin përkatës të vendimmarrjes.

57. Komisioni Këshillëdhënës e sheh si të rëndësishme që autoritetet në Kosovë në të gjitha nivelet të promovojnë vazhdimësisht tolerancën dhe të dënojnë, shpejtë dhe zëshëm, të gjitha rastet e dhunës ndëretnike dhe incidentet tjera. Kjo është e një rëndësie primare në Kosovë, ku marrëdhëniet ndëretnike janë ende tejte të tendosura dhe të brishta. Duket se, pas reagimit tepër të ngadalshëm ndaj dhunës së marsit 2004, një numër liderësh politikë në IPVQ gradualisht janë duke e kuptuar rëndësinë e mesazheve të tilla, por fatkeqësisht, këto nuk kanë jehonë shumë të gjatë, duke përfshirë edhe në nivelin komunal. Në këtë kontekst, Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se Qeveria e Kosovës ka bërë disa përpjekje për t'i nxitur udhëheqësit komunal t'i dënojnë krimet e etnikisht të motivuar si dhe llojet e tjera të krimeve.<sup>5</sup> Sidoqoftë, shpresohet se rëndësia e praktikave të mira në këtë fushë njëmend të përqafohet dhe vlerësohet nga elita politike e nuk shihet si vetëm hap i domosdoshëm në procesin e zbatimit të standardeve.

### **Roli i mediave**

58. Roli i mediave është faktor themelor në implementimin e Nenit 6 të Konventës Kornizë. Kjo edhe një herë u demonstrua gjatë ngjarjeve të marsit 2004 gjatë së cilave armiqësia ndaj personave që ju përkasin komuniteteve pakicë (kryesisht serbëve, por edhe romëve, ahkalinjve dhe egjiptasve) u nxit nga mënyra se si mediat, posaçërisht mediat elektronike, raportuan mbi ngjarjet. Janë inkurajues hapat që më vonë u ndërmorën nga Komisionari i Përkohshëm për Media (KPM) për ta adresuar këtë shqetësim, dhe duket se që nga atëherë ka pasur progres në këtë drejtim. Progresi i mëtejshëm është i domosdoshëm, poashtu tash që organet vetërregullative të mediave të Kosovës janë duke marrë përgjegjësi shtesë në këtë lëmi. Roli në rritje i organeve vendore duhet të shoqërohet me iniciativa monitoruese për të përcjellur zhvillimet në këtë fushë.

### **Neni 7**

59. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se Korniza Kushtetuese ofron garanci të përgjithshme sa ju përket të drejtave në Nenin 7 të Konventës Kornizë. Në të njëjtën kohë, ekziston domosdoshmëria për reformë të legjislacionit në këtë sferë duke pasur parasysh se disa ligje të aplikueshme, duke përfshirë ligjin mbi mbledhjen publike që

<sup>5</sup> Shih letrën e Kryeministrit të Kosovës, me datë 23 janar 2005, drejtuar Kryetarëve të Kuvendeve Komunale, ripublikuar në Raportin e UNMIK-ut, Shtojca XI.

- daton më 1981, përmbajnë nocione të vjetra dhe nuk pasqyrojnë plotësisht standardet e aplikueshme të të drejtave të njeriut të cekura në Kornizën Kushtetuese.
60. Element kyç në procesin legjislativ reformues është Ligji mbi Lirinë e Mbledhjes, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2005 dhe i cili ende është duke u shqyrtuar nga PSSP-ja. Duke pasur parasysh se ligji do të ketë rëndësi të madhe edhe për anëtarët e komuniteteve pakicë, Komisioni Këshillëdhënës apelon tek autoritetet që të sigurojnë se asnjë pengesë e paduhur të mos paraqitet në procesin e regjistrimit dhe se arsyet për refuzimin e regjistrimit të organizatave joqeveritare nuk janë shumë gjerësisht të shpjeguara. Për më tepër, Komisioni Këshillëdhënës thekson se liria e mbledhjes nuk duhet të shikohet si e drejtë e aplikueshme vetëm në relacion me shoqatat e regjistruara.
  61. Përfaqësuesit e komuniteteve pakicë nuk i kanë raportuar Komisionit Këshillëdhënës vështirësi të mëdha në ushtrimin e lirisë së tyre për t'u mbledhur. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se ka një numër të madh organizatash joqeveritare që janë të regjistruara dhe aktive në Kosovë. Edhe pse sipas rregulloreve aktualisht të aplikueshme,<sup>6</sup> UNMIK-u mund ta refuzojë kërkesën e një shoqate nëse statuti i saj synon shkeljen e “cilësdo rregullore të UNMIK-ut”, sipas Raportit të UNMIK-ut, asnjë kërkesë për regjistrim që nga viti 1999 nuk është refuzuar.
  62. Në të njëjtën kohë, implementimi i të drejtave të Nenit 7, në praktikë ndikohet në masë të madhe nga *de facto* kufizimet e lirisë së lëvizjes dhe problemeve të sigurisë. Problemet e vazhdueshme që ndikojnë në marrëdhëniet ndëretnike dhe qëndrimet e shoqërisë drejt komuniteteve të caktuara mund të kenë efekt ngrirës të marrëdhënieve ndëretnike në natyrën dhe visibilitetin e aktiviteteve të disa shoqatave të pakicave në fushë të caktuara si dhe në ushtrimin e lirisë së shprehjes së personave që ju përkasin komuniteteve pakicë (shih poashtu komentet në Nenin 9).

## Neni 8

63. Implementimi i së drejtës për ta shfaqur religjionin është posaçërisht sfidues në Kosovë. Përderisa ka disa zhvillime pozitive në këtë fushë sa ju përket disa besimeve, dhuna e kaluar ndëretnike dhe trazirat kanë përfshirë sulme të shumta ndaj objekteve të fesë ortodokse serbe. Sulmet e tilla ishin veçanërisht të shpeshta gjatë ngjarjeve të marsit 2004 (shih poashtu komentet në Nenin 5). Përpos pyetjeve kyçe për mbrojtjen dhe rindërtimin e këtyre objekteve, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se është esenciale që autoritetet si dhe liderët fetarë të tregojnë respekt për diversitetin fetar të Kosovës, dhe të punojnë me përkushtim për rritjen e tolerancës dhe respektit të ndërsjellë në këtë fushë.
64. Komisioni Këshillëdhënës poashtu i kushton rëndësi të madhe procesit aktual të miratimit të ligjit mbi Liritë Fetare dhe Statusit Ligjor të Komuniteteve Fetare si dhe përpjekjeve të autoriteteve për të pasur proces hartues gjithëpërfshirës. Është thelbësore që ligji vijues të jetë në pajtim të plotë me parimet e Nenit 8 të Konventës Kornizë. Në

<sup>6</sup> Rregullorja e UNMIK-ut No. 1999/22 mbi Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Joqeveritare në Kosovë.

këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës i mirëpret përmirësimet e raportuara në draft dhe shpreson se do të ndihmojnë në përfshirjen e përfaqësuesve të Kishës Ortodokse Serbe në procesin hartimit.

## **Neni 9**

65. Komisioni Këshillëdhënës thekson se nuk ka ndonjë kufizim formal për përdorimin e gjuhëve të pakicave në media në Kosovë dhe Kreu 4 i Kornizës Kushtetuese përmban dispozita të lavdërueshme mbi të drejtën e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre për informata në gjuhën e tyre si dhe për qasjen dhe përfaqësimin e tyre në mediat publike elektronike si dhe në skemën programore në gjuhë përkatëse.
66. Sa i përket praktikës, Komisioni Këshillëdhënës ka vërë vë dukje informatat nga Raporti i UNMIK-ut mbi numrin e konsiderueshëm të gjuhëve të pakicave në media. Sidoqoftë, përfaqësuesit e një numri komunitetesh pakicë kanë raportuar për mangësi lidhur me situatën në fushën e mediave. Edhe pse situata e mediave të shtypura nuk janë plotësisht të kënaqshme, duke përfshirë goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, pika kryesore e shqetësimit ka të bëjë me qasjen e komuniteteve pakicë në mediat elektronike.
67. Sa i përket licencimit të mediave elektronike, që aktualisht është përgjegjësi e Komisionarit të Përkohshëm për Media (KPM), shqetësimi kryesor që ju kumtua Komisionit Këshillëdhënës është procedimi i aplikimeve për licenca të transmetimit në vende që aktualisht nuk janë të mbuluara dhe aplikimet për stacione multietnike. Procesi ka pasur vonesa të konsiderueshme dhe disa anëtarë të komuniteteve pakicë ende janë duke pritur përgjigje për aplikimet e tyre të cilat i kanë parashtruar pas fillimit të procesit në dhjetor 2003. Komisioni Këshillëdhënës e sheh të rëndësishme që KPM-ja të procedojë aplikacionet e përmendura si prioritare dhe Komisioni shpreson se vendimet për licencime që do të përmirësonin qasjen e mëtejme të anëtarëve të komuniteteve pakicë në media elektronike do të merren së shpejti.
68. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se Rregullorja e UNMIK-ut No. 2001/13 mbi Themelimin e Radio Televizionit të Kosovës përmban garanci konkrete për përqindjen e programeve në gjuhën e pakicave, duke ofruar kështu jo më pak se 15% të skemës programore të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), dhe duke përfshirë kohën kryesore të lajmeve në gjuhë(n)t e komuniteteve gjuhës së popullatës shumicë në televizion dhe në transmetimet e kombinuara të radio-frekuencave të RTK-së. Komisioni Këshillëdhënës ishte i kënaqur të dëgjonte se garancitë e tilla, megjithëse të formuluar në mënyrë më fleksibile, poashtu janë përfshirë në draftin e Ligjit për RTK, që është duke u përgatitur, dhe se dispozita më të përgjithshme mbi këtë çështje poashtu janë përfshirë në draftin e ligjit për gjuhët.
69. Bazuar në obligimin e lartpërmendur, RTK-ja rregullisht transmeton programe të gjuhëve të minoriteteve, duke përfshirë gjuhën boshnjake, rome, serbe dhe turke. Përpos këtyre masave pozitive, Komisioni Këshillëdhënës inkurajon RTK-në të merr parasysh

edhe nevojat specifike të komuniteteve tjera pakicë, si ashkalinjtë dhe egjiptasit, gjuha amtare e të cilëve kryesisht është shqipja.

70. Edhe disa shqetësime nga anëtarët e komuniteteve pakicë janë shprehur e të cilat duket se rezultojnë nga vështirësitë teknike. Këto përfshijnë mungesën e pranimit të sinjalit të shërbimit publik televiziv në disa vende kryesisht të banuara nga komuniteti goran dhe boshnjak, ku banorët pavarësisht kësaj janë të detyruar, sipas rregullores së UNMIK-ut në këtë lëmi, ta paguajnë taksën e rregullt në mbështetje të televizionit dhe radio stacioneve të RTK-së. Duke qenë se problemet e tilla me pranim të sinjalit poashtu prekin edhe popullatën shumicë në disa vende të caktuara, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se kjo është një çështje e rëndësishme jo vetëm sa i përket qasjes së personave në media por edhe sa i përket pjesëmarrjes dhe integritetit të tyre.

## **Neni 10**

### **Korniza ligjore për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve**

71. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se parimet e Nenit 10, paragrafi 2, mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave me autoritetet publike, janë kryesisht të pasqyruara në kornizën ligjore të Kosovës, me garanci të shpërndara nëpër tekste të ndryshme ligjore duke përfshirë Kornizën Kushtetuese, Rregulloren e UNMIK-ut No. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë dhe Ligjin mbi Zbatimin e Barazisë së Gjuhëve dhe Alfabetëve në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës i vitit 1977 (1977 Ligji i KSA-së mbi Gjuhët). Nga normat e lartpërmendura thuhet se gjuha shqipe dhe serbe do të përdoren në nivel të barabartë.
72. Garancitë ligjore lidhur me përdorimin e gjuhëve të komuniteteve gjuha e të cilëve nuk është as shqipja e as serbishtja poashtu ekzistojnë. Këto përfshijnë mundësinë për anëtarët e këtyre komuniteteve t'i drejtohen Kuvendit të Kosovës në gjuhën e tyre dhe të kenë qasje në legjislacion të përkthyer në gjuhën e tyre. Dispozita të ngjashme janë të pranishme edhe në nivelin komunal ku anëtarët e këtyre komuniteteve e kanë të drejtën të komunikojnë me organet komunale dhe me shërbyesit civilë komunal në gjuhën e tyre.
73. Sidoqoftë, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se korniza ligjore aktuale është tejet e ndërlikuar dhe se nuk specifikon mjaft qartë rregulloret operative lidhur me përdorimin e gjuhës. Në veçanti, legjislacioni ekzistues nuk i definon kushtet që shoqërojnë përdorimin e gjuhëve të ndryshme nga shqipja dhe serbishtja në kontakte me autoritete apo statusin e mundshëm zyrtar të këtyre gjuhëve. Komisioni Këshillëdhënës thekson se, në mungesë të ndonjë kufiri në legjislacion, komunave ju mbeten përgjegjësi mjaft të lira në përcaktimin e dispozitave lidhur me përdorimin e gjuhëve të komuniteteve nëpër komuna përkatëse. Udhëzuesi i vetëm gjendet në Kreun 9 të rregullores së sipërpërmendur të UNMIK-ut ku theksohet nevoja për marrjen parasysh të përbërjes etnike të popullatës në komunë.

74. Komisioni Këshillëdhënës thekson se situatë lidhur me përdorimin e gjuhës turke është posaçërisht e paqartë. Ligji i KSA-së i vitit 1977 mbi Gjuhët – i cili përmban dispozita që ende janë të aplikueshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 – flet për barazinë e përgjithshme të gjuhës shqipe, serbe dhe turke por poashtu thotë se turqishtja mund të përdoret në shkallë të njëjtë si edhe shqipja dhe serbishtja “në vendet ku jetojnë anëtarët e pakicës turke”. Komisioni Këshillëdhënës merr vesh se këto dispozita kanë shkaktuar pritje në mesin e komunitetit turk, duke përfshirë interpretime se gjuhës turke do t’i jepet status i ngjashëm me atë shqipe apo serbe në Kosovën e sotme, pavarësisht rëndësisë numerike të komunitetit turk që jeton në rajone të caktuara. Kjo çështje kërkon qartësim.

### **Përdorimi i gjuhëve të pakicave në praktikë**

75. Sa i përket praktikës, Komisioni Këshillëdhënës thekson se ka zbrastësira serioze në zbatimin e të drejtave gjuhësore të personave nga komunitetet pakicë. Grupi Veprues mbi Zbatimin e Standardit të Gjuhës, themeluar në janar 2004, ka konkluduar, siç ceket në Raportin e UNMIK-ut, se “përdorimi i lirë dhe respekti i kërkesave ligjore të gjuhëve vazhdon të jetë pasiv në rastet më të mira kurse në më të këqijat të mospërfillet”. Komisioni Këshillëdhënës është i vetëdijshëm se Kosova ballafaqohet me probleme kapaciteti, duke përfshirë objekte joadekuate, mungesë të përkthyesve të kualifikuar dhe resurse të kufizuara, për t’i zbatuar standardet gjuhësore. Këto probleme kapaciteti kanë rezultuar, *inter alia*, në mospërputhje të përkthimeve të ligjeve në gjuhën shqipe dhe serbe dhe poashtu është arsye për numër të kufizuar të ligjeve të përkthyer në gjuhët tjera të komuniteteve. Në të njëjtën kohë, Komisioni Këshillëdhënës mëson se në disa vende mungesa e vullnetit politik për të zbatuar dispozitat e gjuhës poashtu kontribuon në një gjendje të këfillë. Në veçanti, masat implementuese kanë qenë të kufizuara vetëm në ato komuna që dominohen nga një komunitet.

76. Komisioni Këshillëdhënës cek se kodi i përkohshëm penal garanton shërbime përkthimi gratis për persona të cilët nuk mund ta kuptojnë gjuhën e procedurës penale, që është në vijë me Nenin 10, paragrafi 3, të Konventës Kornizë. Sidoqoftë, Komisioni Këshillëdhënës vlerëson se implementimi i këtyre garancive dallon dukshëm, varësisht nga faktorët si shkathhtësia gjuhësore e kuadrit gjyqësor, disponueshmëria e përkthyesve si dhe juridiksioni në të cilin zhvillohet procedura penale. Komisionit Këshillëdhënës i është raportuar për mangësi nëpër disa gjykata, duke përfshirë edhe raporte se anëtarët e komuniteteve pakicë u është kërkuar të nënshkruajnë dokumente gjyqësore në gjuhë të cilën ata nuk e kanë kuptuar. Komisioni Këshillëdhënës apelon tek organet kompetente të monitorojnë me kujdes respektimin e dispozitave gjuhësore nga ana e gjykatave në mënyrë që të shmangen incidente të tilla në të ardhmen.

77. Në dritën e mangësive të identifikuar më lartë, Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret procesin e nisur nga Ministria e Shërbimeve Publike, nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, për miratimin e një ligji gjithëpërfshirës mbi gjuhët. Ky proces synon të ofrojë qartësi, parashikueshmëri dhe zbatueshmëri ndaj rregulloreve lidhur me përdorimin e gjuhës në vende të ndryshme, si dhe në raporte me administratën publike. Poashtu e mirëpret

faktin se ky proces ka përfshirë konsultime me shoqërinë civile si dhe përfaqësues të komuniteteve pakicë. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se miratimi i një kornize ligjore të përmirësuar, shoqëruar me ngritje adekuate të vetëdijes dhe trajnime për nëpunësit civilë dhe shoqërisë civile në përgjithësi si dhe ndërmarrja e masave konkrete për t'i informuar peronat nga komunitetet pakicë mbi të drejtat e tyre është e një rëndësie thelbësore. Trajnim adekuat gjuhësor poashtu duhet t'ju ofrohet nëpunësve civilë në mënyrë që të ndërtohet kapaciteti i mjaftueshëm për zbatimin e ligjit të ri pas miratimit të tij.

## **Neni 11**

### **Shenjat publike dhe treguesit e tjerë topografikë në gjuhët e komuniteteve pakicë**

78. Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut No. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, shenjat zyrtare që tregojnë emrat e vendbanimeve, të rrugëve dhe treguesit tjerë topografikë të dedikuara publikut duhet të vendosen edhe në gjuhën shqipe edhe atë serbe, dhe se emërtimet e 30 komunave të Kosovës dhe vendbanimeve duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe serbe, duke pasur rekomandimet e Komisionit mbi Emërtime të Vendeve.
79. Sidoqoftë, Komisioni Këshillëdhënës thekson se vendosja e shenjave dygjuhësore në praktikë ka qenë e ngadalshme. Edhe pse ka pasur progres kohëve të fundit në disa komuna, Komisioni Këshillëdhënës është i shqetësuar se rregulloret ekzistuese të detajuara shpeshherë nuk janë përfillur nga komunat dhe, në disa raste, edhe janë shkelur. Komisioni Këshillëdhënës poashtu është në dijeni se një numër shenjash në gjuhën serbe janë dëmtuar. Komisioni Këshillëdhënës në veçanti është i brengosur se, siç thuhet në Raportin e UNMIK-ut, ka pasur tentime për t'i "shqiptarizuar" emrat e disa komunave. Komisioni Këshillëdhënës e sheh si thelbësore që, në kontekstin e Kosovës, emrat e vendbanimeve, rrugëve dhe indikatorëve të tjerë topografikë të dedikuara publikut të pasqyrojnë në mënyrë të duhur tiparet multietnike të vendit në pyetje, dhe që masat adekuate, duke përfshirë edhe ato gjyqësore, të jenë në dispozicion në rastet kur bëhen ndryshime ilegale.
80. Komisioni Këshillëdhënës më tej thekson se Rregullorja No. 2000/45 parasheh vendosjen e emërtimeve të vendbanimeve dhe treguesve tjerë në gjuhët e komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është as shqipja as serbishtja, në ato komuna ku komunitetet përbëjnë pjesë të konsiderueshme të popullatës. Komisioni Këshillëdhënës ndjen keqardhje se kjo dispozitë rrallë është zbatuar në komunat në pyetje. Ekzistojnë kërkesa të ndryshme të pazgjdhura nga persona që ju takojnë komunitetit boshnjak, turk dhe romë për të pasur më shumë shenja në gjuhët e tyre në komunat ku ata përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës.
81. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se ekziston nevoja për përcaktimin e rregulloreve të mëtejme ligjore dhe administrative për të qeverisur vendosjen e emrave dhe treguesve topografikë në gjuhët e këtyre komuniteteve dhe se këto do të duhej të merrnin parasysh kërkesat për indikatorë të tillë. Komisioni Këshillëdhënës poashtu

konsideron se autoritetet qendrore duhet t'i inkurajojnë autoritetet komunale që të implementojnë dispozitat aktuale në aspekt më të gjerë. Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës thekson se dy të tretat e shumicës që kërkohet në nivelin komunal për të miratuar një vendim për emërtimin e një rruge apo ndonjë hapësire publike (Kreu II i Rregullores së UNMIK-ut No. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë) ka qenë pengesë për përpjekjet e rritjes së përdorimit të gjuhëve të pakicave, për shembull në komunën e Prizrenit, dhe rregulla e përmendur ndoshta duhet të shqyrtohet.

### **Regjistrimi i emrave personal**

82. Komisioni Këshillëdhënës është informuar për raste kur regjistrimi në gjuhën shqipe i emrave dhe mbiemrave të personave të komuniteteve joshqiptare ka çuar deri te ndryshime. Komisioni Këshillëdhënës është në dijeni për ndërlikueshmërinë e situatës në Kosovë ku përdoren alfabetet dhe shkronjat të ndryshme, dhe konsideron se mungesa e rregulloreve të detajuara mbi këtë çështje duhet të adresohet. Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës mirëpret faktin se janë dhënë garanci në draftin e ligjit mbi gjuhët ku thuhet se regjistrimi i emrave të personave që ju takojnë komuniteteve pakicë gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuha zyrtare, do të regjistrohen në formën e tyre origjinale, në drejtshkrimin e tyre dhe sipas traditës dhe sistemit gjuhësor të gjuhës së tyre. Përderisa implementimi i dispozitave të tilla padyshim do të përbënte një zhvillim pozitiv, Komisioni Këshillëdhënës shpreson se poashtu do të ndërmerren masa adekuate për të siguruar se personat emrat e të cilëve janë ndryshuar në të kaluarën të kenë mundësinë e përmirësimit të tyre në formën origjinale dhe se do të sigurohen procedura për ta zbatuar këtë masë.

### **Shenjat e natyrës private**

83. Komisioni Këshillëdhënës ju referohet komenteve të ndërlidhura në Nenin 10 dhe thekson se ndjenja e lartpërmendur e pasigurisë poashtu ka kontribuar në një hezitim për të vendosur shenja të natyrës private në gjuhën serbe apo gjuhët e tjera sllave në disa vende të caktuara në Kosovë. Komisioni Këshillëdhënës konstaton se kjo paraqet, *de facto*, një kufizim serioz për implementimin e Nenit 11, paragrafit 2, të Konventës Kornizë.

### **Neni 12**

#### **Kontaktet ndërkulturore në arsim**

84. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se implementimi i parimeve të Nenit 12 të Konventës Kornizë është i një rëndësie primare për të siguruar se sistemi shkollor i Kosovës është i disenjuar asisoj që të promovojë dialogun ndëretnik dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. Autoritetet kërkohen të ndërmarrin veprime të vendosura për ta trajtuar mosbesimin dhe tensionimet ndëretnike që ende ndihen mjaft thellë në shoqërinë kosovare. Komisioni Këshillëdhënës i njuh sfidat me të cilat ballafaqohen autoritetet janë të mëdha: ato duhet të merren me historinë e të së kaluarës si dhe me atmosferën politike pas konfliktit që rrezikon ta shndërrojë arsimin në fushëbetëje politike.

85. Operacioni i vazhdueshëm i “shkollave paralele”, financuar nga Ministria Serbe e Arsimit dhe Sportit dhe zhvilluar sipas planprogramit serb, do të thotë *de facto* ekzistimin e një sistemi të ndarë shkollor. Duke përjetësuar distancimin e nxënësve serbë nga komuniteti shumicë, ekzistimi i sistemit shkollor paralel poashtu pasqyron mungesën e besimit dhe shqetësimeve për siguri nga ana e komunitetit serb ndaj institucioneve të arsimit të Kosovës. Kjo paraqet sfidë serioze në arritjen e një sistemi të unifikuar të arsimit.
86. Në Kosovën e sotme, duke pasur parasysh praninë e disa iniciativave shkollore të përbashkëta, mundësia për nxënësit serb dhe shqiptar që të bashkëveprojnë në kontekstin e sistemit shkollor shpesh nuk ekziston fare dhe bashkekzistenca e tyre në të njëjtën shkollë është poashtu mjaft vështirë të arrihet. Komisioni Këshillëdhënës konstaton se ende ka pikëpamje të përgjithshme se vijimi i mësimin në shkolla të përbashkëta nuk është i sigurt. Kjo ndjenjë është shtuar edhe më shumë nga ngjarjet e marsit 2004, gjatë të cilave shkollat serbe poashtu ishin cak i sulmeve. Shqetësimet për siguri i kanë shtyrë nxënësit serbë të udhëtojnë nëpër enklava në mënyrë që të arsimohen përkundër kushteve të rënda të transportit. Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës vlerëson se autoritetet duhet të japin mbështetje të fortë përpilimit të një plani gjithëpërfshirës i cili do të bënte përpjekje për t'i mënjeluar pengesat aktuale në mes të nxënësve shqiptarë dhe serbë, duke i kushtuar më shumë vëmendje kësaj çështjeje në kontekstin e Planit të Zbatimit të Standardeve për Kosovën.

### **Përmbajtja multikulturore e arsimit**

87. Arsimi ka rol kyç në procesin e pajtimit. Përpjekje të vendosura nga autoritetet kompetente nevojiten për të siguruar se toleranca dhe diversiteti pasqyrohen drejtë në të gjitha komponentët e sistemit arsimor. Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret faktin se një planprogram i ri e i unifikuar, i cili është i aplikueshëm edhe për nxënësit e komuniteteve pakicë, është përpiluar më 2002 sipas standardeve evropiane. Komisioni Këshillëdhënës thekson se ky planprogram përfshin elemente specifike të disajnuara për komunitetin boshnjak dhe turk respektivisht dhe se është duke u punuar për adaptimin e tij ndaj nevojave të nxënësve serbë nëpër klasa të selektuara.
88. Përderisa ky është zhvillim pozitiv, Komisioni Këshillëdhënës e sheh esenciale që të ndërmerren masa të përforcuara për të ofruar materiale të reja pedagogjike që marrin parasysh kontributin e të gjitha komuniteteve në shoqërinë e Kosovës (shih Nenin 14). Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës thekson se anëtarët e komunitetit ashkali dhe egjiptas janë ankuar se kulturat dhe traditat e tyre përkatëse nuk janë pasqyruar në planprogramin e reviduar apo në tekstet shkollore. Komisioni Këshillëdhënës inkurajon autoritetet kompetente që t'i marrin parasysh këto komente gjatë përpjekjeve të tyre të ardhshme për të ngritur kualitetin e arsimit në Kosovë dhe të sigurohet në përfshirjen e konsultimeve të mjaftueshme me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në iniciativat në fushën e arsimit.

### **Situata e arsimit të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve**

89. Komisioni Këshillëdhënës është posaçërisht i brengosur me situatën e nxënësve romë, ashkalinjë dhe egjiptas sa i përket qasjes së tyre në arsim. Gjendja arsimore e këtyre komuniteteve karakterizohet me shkallë tejet të ulët të vijimit të shkollës dhe me shkallë të lartë të braktisjes së shkollës. Situata shkolluese është sidomos alarmante në mesin e vajzave që ju takojnë këtyre komuniteteve. Komisioni Këshillëdhënës merr vesh se ekziston një sërë faktorësh që e shpjegojnë situatën e tyre të rëndë arsimore, duke përfshirë kushtet e vështira socio-ekonomike në të cilat këto komunitete jetojnë. Sa ju përket romëve, mungesa e vetëdijesimit në mesin e vet komunitetit rreth rëndësisë së arsimimit poashtu është pengesë siç është edhe mungesa e vetëdijesimit të prindërve rreth nevojës së regjistrimit të fëmijëve të tyre në mënyrë që të kenë qasje në një numër shërbimesh, duke përfshirë arsimin. Komisioni Këshillëdhënës është në dijeni se disa iniciativa pozitive janë duke u implementuar nga OJQ të këtyre komuniteteve në ndërlidhje me prindërit e nxënësve për të mënjeluar këto pengesa. Iniciativat e tilla janë të lavdërueshme dhe duhet të inkurajohen dhe të marrin mbështetjen e duhur.
90. Komisioni Këshillëdhënës thekson se një numër i madh i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve kanë qëndruar jashtë sistemit shkollor gjatë viteve të fundit dhe duhet të reintegrohen në sistemin shkollor. Komisioni Këshillëdhënës i mirëpret përpjekjet e bëra nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me mbështetjen e OSBE-së dhe OJQ-ve ndërkombëtare për ta adresuar këtë problem duke ofruar klasë plotësuese për fëmijët nga këto komunitetet në mënyrë që t’ju ndihmojnë atyre të integrohen në shkolla të rregullta. Komisioni Këshillëdhënës e sheh si inkurajuese se rezultatet e para të këtij programi intensiv janë vlerësuar pozitivisht, duke përfshirë edhe nga anëtarët e këtyre komuniteteve. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se është e rëndësishme që qëndrueshmëria e një programi të tillë të sigurohet jo vetëm përmes ndarjes së mjeteve të mjaftueshme financiare por edhe përmes sigurimit të kuadrit adekuat mësimdhënës për ta garantuar suksesin e programit. Komisioni Këshillëdhënës poashtu është informuar se vajzat rome duket se nuk kanë përfituar sa duhet nga ky program dhe rekomandon që vëmendje e kujdesshme t’i kushtohet kësaj çështje.
91. Komisioni Këshillëdhënës e vlerëson pozitivisht faktin se vendosja e romëve në “shkolla speciale” nuk është fenomen që ekziston në Kosovë. Sidoqoftë, Komisioni Këshillëdhënës është i brengosur me rastet e raportuara të keqtrajtimit, kërcënimit dhe stigmatizimit në mesin e nxënësve që i takojnë këtij komuniteti si dhe në mesin e nxënësve nga komuniteti ashkali dhe egjiptas. Këto fenomene, raportohet të adresohen shumë rrallë nga autoritetet e shkollave. Komisioni Këshillëdhënës thekson se institucionet arsimore kanë detyrë specifike që të reagojnë energjikisht kundër këtyre rasteve. Veprime të mëtutjeshme duhet të ndërmerren nga autoritetet për të përmirësuar pozitën e këtyre komuniteteve në sistemin shkollor, duke u bazuar në parimet në Rekomandimin e Komitetit të Ministrave No. (2000) 4 mbi arsimimin e fëmijëve romë në Evropë. Më përgjithësisht, Komisioni Këshillëdhënës vlerëson se përderisa ekzistojnë iniciativa të vlefshme sektoriale e lokale, duhet të disenjohet një strategji gjithëpërfshirëse që mbulon arsimin e këtyre komuniteteve në mënyrë që t’ju ndihmojë

në integrimin e suksesshëm dhe qëndrimin në shkolla duke ruajtur në të njëjtën kohë identitetet e tyre specifike.

### **Qasja në arsim të lartë**

92. Sa i përket qasjes në arsim të lartë, Komisioni Këshillëdhënës thekson se Rregullorja e UNMIK-ut No. 2003/14 mbi Shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Arsimin e Lartë parashihet se arsimi i lartë i ofruar nga institucionet e licencuara në Kosovë “do të jetë i mundshëm për të gjithë personat në territorin e Kosovës (...) pa diskriminim direkt apo indirekt për ndonjë arsye reale apo të supozuar që ka të bëjë me origjinën kombëtare, etnike (...), përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar”. Komisioni Këshillëdhënës thekson se përderisa sistemi i kuotave për komunitetet pakicë ekziston në Universitetin e Prishtinës që nga viti 2004 në mënyrë që të ngritë pjesëmarrjen e tyre në arsimin e lartë, arsimi në këtë universitet është vetëm në gjuhën shqipe duke ofruar mundësi që provimet të jepen edhe në gjuhën serbe. Sidoqoftë, kjo nuk ju përgjigjet nevojave të komuniteteve që flasin gjuhën serbe apo boshnjake. Këto komunitete mund të arsimohen në gjuhën e tyre vetëm përmes strukturave paralele (shih më poshtë paragrafin 94) apo edhe në Shkollën e Biznesit në Pejë apo Fakultetin e Pedagogjisë në Prizren, të cilat ofrojnë mësim edhe në gjuhën boshnjake.
93. Komisioni Këshillëdhënës thekson se qasja në arsim të lartë për anëtarët e komuniteteve pakicë ndërlikohet edhe më tej nga implementimi i reformave të arsimit, të miratuara në Kosovë më 2002. Reformat mëtojnë një qëllim të lavdërueshëm për përshtatjen ndaj sistemit evropian të shkollimit. Sidoqoftë, si rezultat i kësaj, sistemi në Kosovë dallon nga këto sisteme arsimore të rajoneve që veqme i kanë zbatuar këto reforma. Kjo ka krijuar pengesa shtesë për anëtarët e komuniteteve sllavo-folëse në vijimin e arsimit të lartë në universitetet jashtë Kosovës, në Serbi dhe Mal të Zi dhe në vende të tjera të. Në veçanti, komuniteti goran është nën presion për t’ju përshtatur këtij sistemi të ri, i cili nuk i plotëson domosdoshmërisht nevojat arsimore të të gjithë nxënësve që i takojnë këtij komuniteti. Përderisa përjashtime vjetore të aplikueshmërisë së këtij sistemi të ri janë mundësuar nga MASHT-i deri në këtë vit, duket se autoritetet nuk janë të gatshme që të tregojnë edhe më tutje një fleksibilitet të tillë. Komisioni Këshillëdhënës e sheh të rëndësishme që, varësisht nga implementimi më i gjerë i reformave të arsimit të rajon, MASHT-i të tregojë fleksibilitet lidhur me këtë çështje dhe të gjejë një zgjidhje, ashtu që procesi i arsimit i atyre anëtarëve të komunitetit goran të cilët ende nuk janë integruar në sistemin e ri të arsimit, të mos pengohet siç është rasti aktualisht.
94. Komisioni Këshillëdhënës thekson se, pas Rregullores së UNMIK-ut No. 2003/14 mbi Shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, u legalizua Universiteti i Mitrovicës veriore. Ky Universitet, i cili udhëhiqet nga autoritetet serbe, është universiteti i vetëm që ofron arsim të lartë në gjuhën serbe në Kosovë. Studentët e këtij universiteti përfshijnë jo vetëm serbë por edhe boshnjakë, goranë dhe të tjerë të cilët nuk janë në gjendje ta vijojnë arsimin e lartë në gjuhën shqipe. Komisioni Këshillëdhënës është informuar për raportet ku thuhet se studentët që diplomojnë nga Universiteti i Mitrovicës veriore, diplomat e të cilëve pranohen *de*

*jure* (duke mos përjashtuar vështirësitë prezente), mund të hasin në vështirësi gjatë punësimit në vendbanimet e përziera dhe/ose në regjistrimin në programet e universitetit të udhëhequr nga shqiptarët sepse dokumentet e lëshuara nga strukturat paralele nuk janë valide në praktikë. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se përderisa këto probleme lidhen me çështjen e përgjithshme të statusit të arsimit universitar serb në Kosovë, ato duhet të trajtohen në mënyrë të duhur varësisht nga zgjidhja e çështjes së përgjithshme.

95. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se disponueshmëria e arsimit të lartë në gjuhën amtare mund të jetë faktor kyç në vendimin për të mbetur në Kosovë. Së bashku me qasjen në nivelet fillore dhe të mesme të shkollimit në gjuhën amtare (shih poashtu komentet në Nenin 14), mundësia për shkollim të lartë është duke ndikuar në vendimet për kthim të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Kjo duhet të pasqyrohet në politikat dhe praktikat e zhvilluara në këtë fushë. Për më tepër, Komisioni Këshillëdhënës dëshiron të nënvizojë se roli i rëndësishëm i gjuhës serbe në organet zyrtare dhe kontekstet tjera në Kosovë, pasqyrohet *inter alia* në Kornizën Kushtetuese dhe në draftin e ligjit mbi gjuhët, gjë që nënkupton nevojën për sigurimin e shkathtësive dhe kapaciteti adekuat gjuhësor përbrenda sektorëve të ndryshëm publikë. Kjo poashtu duhet të merret parasysh në përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave të arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë.

### **Neni 13**

96. Komisioni Këshillëdhënës thekson se e drejta e personave që ju takojnë komuniteteve pakicë për të themeluar struktura të veta private për arsim dhe trajnim garantohet në Kaptinën IV të Kornizës Kushtetuese, ku poashtu thuhet se asistencë financiare mund të ofrohet duke përfshirë edhe nga fondet publike në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
97. Sipas statistikave në Raportin e UNMIK-ut, regjistrimi në institucionet private arsimore nga ana e komuniteteve pakicë është relativisht i ulët. Komisioni Këshillëdhënës nuk është në dijeni për ndonjë kërkesë të bërë nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve për të themeluar institucione të tilla, prandaj konsideron se zbatimi i këtij neni nuk çon deri të ndonjë vërejtje specifike.

### **Neni 14**

#### **Korniza ligjore**

98. Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret faktin se e drejta e personave të komuniteteve të arsimohen në gjuhën e tyre garantohet në Kornizën Kushtetuese. Komisioni Këshillëdhënës thekson se nuk ka asnjë dispozitë në legjislacionin ekzistues ku identifikohet minimumi i numrit të nxënësve që janë të domosdoshëm për ta hapur një klasë me mësim në gjuhën e pakicave edhe pse duket se në praktikë ekziston një rregull që kërkon minimumin e 15 nxënësve. Ky numër duket i arsyeshëm në një numër kontekstesh, por paraqet probleme për komunitetet numerikisht të vogla, si boshnjakët të cilët shpeshherë nuk janë në gjendje ta arrijnë atë kufi. Komisioni Këshillëdhënës

mendon se situata lidhur me këtë kufi duhet të qartësohet, duke përfshirë miratimin e një rregulloreje konkrete ku do të mundësohej fleksibiliteti për t'ju përshtatur, sa më shumë të jetë e mundur, kërkesave të parashtruara nga grupet më të vogla.

### **Trajnimi i mësimdhënësve, tekstet shkollore, qasja fizike në objektet arsimore**

99. Në fushën e praktikës, Komisioni Këshillëdhënës thekson se përderisa implementimi i kësaj të drejte dhe problemet e hasura ndryshojnë varësisht nga komunitetet në pyetje, disa probleme si mungesa e teksteve shkollore dhe kuadrit profesional për mësimdhënie në gjuhë amtare janë të përbashkëta për të gjitha komunitetet pakicë. Duke cekur se ekziston një bashkëpunim i frytshëm në pajisjen me libra me Turqinë dhe Bosnjën e Hercegovinën, Komisioni Këshillëdhënës nënvizon se tekstet shkollore të importuara nuk i pasqyrojnë në mënyrë adekuate përvojat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se vëmendje më e madhe duhet të ofrohet në mbështetjen e publikimit të teksteve shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë dhe se duhet të përgatitet një plan në këtë drejtim në konsultim me komunitetet. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se ekziston nevoja për ta rritur përkrahjen poashtu edhe nga burimet ndërkombëtare lidhur me kushtet e punës dhe trajnimin e mësimdhënësve të gjuhëve minoritare, duke përfshirë mësimdhënës të gjuhës boshnjake.

100. Qasja fizike në objektet arsimore me mësim në gjuhën amtare identifikohet si një problem i shpeshtë nga ana e përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme, si boshnjak, turk dhe goran, përkundër thirrjeve që i janë bërë vazhdimisht viteve të fundit UNMIK-ut dhe MASHT-it për të përpiluar një plan gjithëpërfshirës për të siguruar transport të sigurt për komunitetet pakicë. Kjo ka të bëjë edhe me komunitetin serb liria e lëvizjes së të cilit paraqet sfida të mëdha rreth qasjes në arsim jashtë lokacioneve ku këto komunitete jetojnë në kompaktësi. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se ekziston nevojë urgjente për të shënuar progres në këtë drejtim, duke pasur parasysh se mungesa e një transporti të tillë e pengon qasjen në arsim në gjuhë amtare të personave që i takojnë një numri komunitetesh pakicë.

### **Shkollat paralele**

101. Sa i përket sistemit paralel shkollor të vijuar nga nxënësit serb si dhe nga nxënës që ju takojnë komuniteteve tjera, probleme specifike janë identifikuar për sa i përket monitorimit të zbatimit të Nenit 14. Përderisa këto shkolla paralele mund të konsiderohen, në rrethanat e tanishme, si një përpjekje për t'ju përgjigjur nevojave arsimore të këtyre komuniteteve në mungesë të shërbimeve përkatëse të ofruara nga institucionet e Kosovës, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se është primare që këto të vihen nën një mbikëqyrje efektive për t'u njohur me përmbajtjen dhe kualitetin e arsimit që këto shkolla ofrojnë.

### **Arsimi në gjuhën rome**

102. Komisioni Këshillëdhënës thekson se, aktualisht, ekzistojnë vetëm mundësi të kufizuara për romët që ta mësojnë gjuhën e tyre, dhe këto kryesisht janë ofruar nga

- organizata joqeveritare. Duke qenë se arsimi në gjuhën rome në përgjithësi nuk është i mundur në Kosovë, fëmijët romë shpesh vijnë në mësimin në gjuhët që fliten nga popullata shumicë në vendin ku banojnë, kështu shpeshherë duke hasur në probleme të cekura në Nenin 12.
103. Komisioni Këshillëdhënës është informuar se kërkesa për të përfshirë gjuhën, historinë dhe kulturën rome në shkolla është parashtruar në nivelin lokal por se këto nuk janë trajtuar nga autoritetet. Komisioni Këshillëdhënës është në dijeni se kjo situatë e pakënaqshme është diskutuar edhe në vitin 2003, kur bisedat në mes të MASHT-it, OSBE-së dhe shoqërisë civile rezultuan në rekomandime që të përfshihet gjuha, historia dhe kultura rome si dhe të përpilohen materiale adekuate të arsimimit. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se hapa praktikë duhet të ndërmerren tani për t'i shndërruar këto rekomandime në mundësi reale për romët që t'i zhvillojnë identitetet e tyre gjuhësore dhe kulturore dhe se kërkesat për një gjë të tillë duhet të merren parasysh në mënyrë të duhur. Për më tepër, konsideratë duhet t'i jepet edhe trajnimit të mësimdhënësve romë të cilët aktualisht janë duke dhënë mësim në gjuhë tjetër si dhe trajnimit të kandidatëve të tjerë të kualifikuar për t'ju mundësuar atyre t'i zhvillojnë shkathësitë konkrete në mësimdhënien e gjuhës rome.
104. Komisioni Këshillëdhënës thekson se arsimi në gjuhën boshnjake dhe turke ofrohet në shkolla ku arsimimi mundësohet në dy apo më tepër gjuhë, gjë që është për t'u lavdëruar në dritën e Nenit 12 dhe 14. Sidoqoftë, Komisioni Këshillëdhënës është informuar edhe për shqetësimet e anëtarëve të komunitetit turk të cilët nuk janë të përfaqësuar denjësisht në bordet shkollore të shkollave përkatëse. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se duhet të sigurohet një qasje pjesëmarrëse në udhëheqjen e shkollave dhe se diversiteti etnik i shkollave duhet të pasqyrohet në mënyrë adekuate në strukturat e tyre të vendimmarrjes.
105. Për sa i përket situatës specifike të goranëve dhe qasjes së tyre në arsim të lartë (shih komentet nën Nenin 12), Komisioni Këshillëdhënës thekson se nevoja për fleksibilitet mbi këtë çështje është e rëndësishme edhe në dritë të implementimit të Nenit 14 të Konventës Kornizë. Komisioni Këshillëdhënës është në dijeni se janë duke u bërë përpjekje për të siguruar tekste shkollore në pajtim me planprogramin e ri dhe apelon tek autoritetet që t'i vazhdojnë këto në mënyrë që ta lehtësojnë integrimin eventual të nxënësve të komunitetit goran në sistemin e ri.

### **Perspektiva për arsim dy/shumëgjuhësor**

106. Komisioni Këshillëdhënës thekson se, në pajtim me Rregulloren No. 2002/19 mbi Shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nxënësit që vijnë në mësimin në një gjuhë minoritare e mësojnë shqipen si gjuhë joamtare si pjesë e sistemit arsimor të unifikuar (dy orë në javë, sipas Raportit të UNMIK-ut). Duke mos qenë në dijeni për ekzistimin e rregulloreve të detajuara lidhur me mësimdhënien e gjuhës shqipe, Komisioni Këshillëdhënës konsideron se autoritetet duhet të sigurohen që të miratohet një qasje e balancuar dhe të implementohet në mënyrë që të mundësojë ruajtjen e gjuhëve të pakicave si pjesë e

identitetit të personave që, në një anë, ju takojnë komuniteteve pakicë dhe integritit të komuniteteve pakicë përmes mësimit të gjuhës shqipe, në anën tjetër.

107. Komisioni Këshillëdhënës është i brengosur lidhur me pengesën gjuhësore që ekziston në mes të komunitetit serb dhe shqiptar. Komisioni Këshillëdhënës i konsideron si inkurajuese disa iniciativa lokale që t'ju mundësojnë shqiptarëve të mësojnë serbisht dhe konsideron se këta shembuj të mirë duhet të zgjerohen, duke përfshirë edhe në kontekstin e sistemit arsimor publik. Kjo do të ishte e rëndësishme për zhvillimin e komunikimit ndëretnik (shih poashtu Nenin12).

### **Neni 15**

108. Komisioni Këshillëdhënës shpreh keqardhje për faktin se Raporti i UNMIK-ut ofron vetëm informata të kufizuara mbi implementimin e Nenit 15 në Kosovë. Ky raportim i kufizuar sugjeron se rëndësia dhe fushëveprimi i këtij Neni nuk çmohet sa duhet nga autoritetet raportuese.

### **Pjesëmarrja në bisedime për status**

109. Komisioni Këshillëdhënës është i mendimit se një nga çështjet kryesore lidhur me pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë është mënyra se si do të përfshihen ata në bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës. Duke marrë parasysh se bisedimet me siguri do të mbulojnë shumë çështje që ndikojnë në statusin e ardhshëm dhe mbrojtjen e komuniteteve pakicë në Kosovë, Komisioni Këshillëdhënës pajtohet me përfaqësuesit e komuniteteve pakicë të cilët janë shprehur se përfshirja efektive e të gjitha komuniteteve të Kosovës, dhe jo vetëm komuniteti shqiptar dhe serb, duhet të sigurohet në këtë proces. Kjo është kyçe jo vetëm në dritën e parimeve në Nenin 15 të Konventës Kornizë por edhe për të siguruar se rezultati merr parasysh shqetësimet e të gjitha komuniteteve dhe që të fitojë sa më shumë përkrahje përbrenda shoqërisë. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se kjo çështje – rëndësia e së cilës është pohuar nga shumë bashkëbisedues ndërkombëtarë dhe vendorë gjatë vizitave - duhet të jetë një nga elementet kryesore të vlerësimit të monitorimit të Konventës Kornizë, duke përfshirë këtu edhe nga përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.

### **Pjesëmarrja në organe publike**

110. Më përgjithësisht, pjesëmarrja e personave nga komunitetet pakicë në vendimmarrje është një çështje më të rëndësishme në Kosovën e sotme, dhe kyç për implementimin e jo vetëm Nenit 15 por edhe parimet tjera të Konventës Kornizë. Korniza Kushtetuese përmban dispozita të lavdërueshme mbi përfaqësimin e komuniteteve pakicë në Kuvendin e Kosovës, më saktësisht 20 vende të rezervuara për komunitetet pakicë. Sidoqoftë, përfaqësuesit e komunitetit serb, të cilët kanë të drejtë në 10 ulëse prej 20 ulëse të rezervuara, vetëm në masë të kufizuar i kanë shfrytëzuar mundësitë e tyre për të marrë pjesë në Kuvend dhe në strukturat tjera të IPVQ-së si dhe në Qeverinë e Kosovës. Është e qartë se kjo gjendje dëmton dukshëm ndikimin e tyre në proceset e vendimmarrjes në nivelin qendror.

111. Përbrenda Kuvendit, një nga instrumentet kyçe për t'i adresuar çështjet shqetësuese për komunitetet pakicë është Komisioni mbi të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni Këshillëdhënës ndjen keqardhje se, sipas informatave të siguruar nga anëtarët e Komisionit të përmendur, Ministrat e Qeverisë së Kosovës nuk kanë treguar interes adekuat për pjesëmarrje në mbledhjet e Komisionit e as për hyrje në dialog të drejtpërdrejtë me anëtarët e tij lidhur me çështjet që bien nën mandatin e Komisionit. Anëtarët e këtij Komisioni poashtu konsiderojnë se rekomandimet e tyre nuk janë marrë parasysh sa duhet.
112. Në nivelin lokal, shkalla e pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë në organet politike dallon dukshëm. Përderisa në vendbanimet kompakte të tyre, komunitete të caktuara pakicë në shumë raste kanë fituar nivel të lartë ndikimi në organet komunale, në vendet tjera, për komunitetet numerikisht më të vogla, situata është krejtësisht ndryshe. Për shembull, duket se nuk ka asnjë rom në mesin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Kosovë. Në rrethana të tilla, mekanizmi kryesor që për të siguruar përfshirjen e komuniteteve pakicë në proceset e vendimmarrjes komunale është sistemi i “komisioneve për pakica”. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, të gjitha komunat janë të obliguara t'i themelojnë komisionet për komunitete, në të cilat të gjitha komunitetet që banojnë në komunën përkatëse do të ishin të përfaqësuar. Përgjegjësitë e komisioneve për komuna përfshijnë detyra të rëndësishme që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë, si dhe parandalimin e diskriminimit etnik nga zyrtarët publikë, dhe disa iniciativa premtuese si vizita komuniteteve pakicë poashtu janë paraqitur si detyra. Sidoqoftë, kapaciteti, efektiviteti dhe përfaqësimi i komisioneve të përmendura janë vërë në pyetje nga një numër personash që ju takojnë komuniteteve pakicë. Duket se, përderisa disa komisione të komuniteteve funksionojnë mirë, në një numër komunash komisionet nuk janë në pozitë të ndërmarrin masa proaktive për t'i mbrojtur komunitetet pakicë më të ndjeshme dhe procesi i zgjedhjes së anëtarëve të këtyre komisioneve poashtu ka mangësi. UNMIK-u duhet t'i shtojë përpjekjet për ta përmirësuar këtë situatë. Komisioni Këshillëdhënës sugjeron se procesi zgjedhor dhe modalitetet tjera lidhur me funksionimin e këtyre komisioneve duhet të shqyrtohet për të siguruar se komisionet mund të kryejnë me sukses detyra të rëndësishme dhe të gëzojnë mbështetje maksimale të komuniteteve të cilat duhet t'i mbrojnë.
113. Komisioni Këshillëdhënës nënvizon se procesi i decentralizimit dhe reformës së vetëqeverisjes lokale kanë rëndësi të madhe në pjesëmarrjen e personave nga radhët e minoriteteve dhe për implementimin e parimeve të Nenit 15 në përgjithësi. Komisioni Këshillëdhënës merr vesh se ka mosmarrëveshje substanciale rreth fushëveprimit dhe përmbajtjes së reformës së planifikuar, dhe se kjo ka ndikuar në mënyrën se si janë implementuar pilot projektet. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se është esenciale që procesi të implementohet ashtu që të sigurojë pjesëmarrje efektive të personave që ju takojnë komuniteteve pakicë në proceset e vendimmarrjes por në të njëjtën kohë të merr parasysh situatën e personave që jetojnë, *de facto*, në një situatë “pakicë brenda pakicës”.

## **Punësimi dhe pjesëmarrja në jetën ekonomike**

114. Komisioni Këshillëdhënës e vlerëson vëmendjen e shtuar ndaj punësimit të personave që ju takojnë komuniteteve pakicë në shërbimin civil komunal dhe në strukturat e IPVQ-së në nivelin qendror, që pasqyron prioritetin që i është dhënë kësaj çështje në Planin për Zbatimin e Standardeve për Kosovën. Fushatat informuese dhe masat tjera duket të kenë dhënë përmirësime por pjesëmarrja e komuniteteve pakicë në shumë sektorë ende është tejet e ulët. Komisioni Këshillëdhënës dëshiron të nënvizojë në veçanti nevojën për progres të mëtejshëm në fushën e gjyqësisë, ku numri i personave të komuniteteve pakicë është shumë i ulët, përkundër përpjekjeve të bëra për ta adresuar këtë çështje. Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret progresin e arritur në rekrutimin e policëve nga komunitetet pakicë, dhe inkurajon autoritetet që t'i shqyrtojnë shqetësimet shitesë të shprehura nga komunitetet pakicë në këtë drejtim. Këto përfshijnë problemet e sigurisë që i dekurajojnë serbët, në veçanti, për të aplikuar në pozita të strukturat e zbatimit të ligjit dhe në fusha tjera por gjuha dhe pengesat tjera poashtu janë raportuar nga ana e përfaqësuesve të komunitetit turk rreth qasjes së tyre në Akademinë Policore.
115. Komisioni Këshillëdhënës do të donte të theksojë se procesi i privatizimit ka implikime afatgjata për pjesëmarrjen e personave që ju takojnë komuniteteve pakicë, në veçanti sa i përket pjesëmarrjes së tyre në jetën ekonomike. Komisioni Këshillëdhënës kësaj konsideron se është e nevojshme që implikimet dhe ndikimi i procesit për komunitetet pakicë të shqyrtohen dhe të monitorohen me kujdes dhe të garantohet transparenca e tyre, në mënyrë që të sigurohet se personat nga komunitetet pakicë të kenë qasje të drejtë dhe të barabartë ndaj procesit dhe që të gjitha komunitetet të përfitojnë nga ai. Monitorimi i kujdesshëm duhet të sigurojë se procesi i privatizimit dhe rezultati i tij të mos kenë diskriminim, qoftë ai direkt apo edhe indirekt.
116. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se zgjidhja e suksesshme e kërkesave pronësore është drejtpërdrejtë e lidhur me implementimin e Konventës Kornizë. Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës i mirëpret masat e ndërmarra për t'i adresuar kërkesat pronësore, edhe të shqiptarëve edhe të personave që ju takojnë komuniteteve pakicë, prej vitit 1989 deri më 1999, përmes punës së Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore. Sidoqoftë, tani ekziston një nevojë për t'i shqyrtuar edhe kërkesat rreth pronës bujqësore dhe komerciale përmes një procesi që nuk është diskriminues dhe që mundëson riposëdim efektiv. Kjo është themelore për përmirësimin e perspektivës për pjesëmarrje efektive të personave që ju takojnë komuniteteve pakicë në jetën ekonomike dhe për inkurajimin e kthimit të qëndrueshëm të pakicave. Përfundimisht, është thelbësore që të miratohen masa për procedimin efikas të kërkesave për kompensim lidhur me pronën e dëmtuar gjatën ngjarjeve të marsit 2004, procedimi gjyqësor i të cilave raportohet të jetë suspenduar nga Departamenti për Drejtësi pranë UNMIK-ut.

## **Neni 16**

### **Ndryshimet e popullatës**

117. Komisioni Këshillëdhënës thekson se implementimi i Nenit 16 të Konventës Kornizë është relativisht i ndërlikuar nga konflikti i vitit 1999, që shty një numër të madh njerëzish ta lëshojnë Kosovën dhe shkaktoi zhvendosje të konsiderueshme të brendshme, si dhe nga ngjarjet e dhunshme të marsit 2004, që poashtu shtynë shumë njerëz të ikin. Si rezultat, proporcioni i personave që ju takojnë komuniteteve të ndryshme në vende të ndryshme të Kosovës ka pësuar ndryshime thelbësore, edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për këtë (shih poashtu komentet në Nenin 3).
118. Komisioni Këshillëdhënës është në dijeni të plotë se vendimet për tu kthyer lidhen me përmbushjen e një numri parakushtesh si siguria, garancitë për të drejta pronësore dhe perspektivë socio-ekonomike (duke përfshirë punësimin, dhe mundësinë e arsimimit), dhe se ka disa probleme serioze lidhur me të gjitha këto çështje në Kosovë. Në këtë drejtim, Komisioni Këshillëdhënës e mirëpret përkushtimin politik të shprehur nga IPVQ-të për të siguruar proces të qëndrueshëm të kthimit, edhe pse rezultatet konkrete deri tash kanë qenë modeste. Përshtatja e programeve për asistencë ndaj kthimit ashtu që t'ju ofrojnë të kthyerve më shumë liri për të vendosur se ku në Kosovë dëshirojnë të vendosen me siguri do të kontribuonte në këtë proces (shih edhe komentet në Nenin 4). Komisioni Këshillëdhënës, sidoqoftë, konsideron se është e një rëndësie kyçe që procesi i kthimit të mbrohet prej cilitdo manipulimi politik që do të ishte në kundërshtim me parimet e Nenit 16.

### **Decentralizimi**

119. Decentralizimi është një projekt ambicioz që luan rol në të ardhmen e Kosovës dhe të drejtave të personave nga komunitetet e ndryshme. Përvoja me pilot projektet ekzistuese të decentralizimit tregon se konsultimet adekuate me anëtarët e të gjitha komuniteteve pakicë janë të domosdoshme për përgatitjen e çfarëdo plani në këtë fushë. Komisioni Këshillëdhënës thekson se thekson se trajtimi i decentralizimit në “kornizë më të gjerë (...) që do të përfshinte një numër të komunave të reja ku në veçanti serbët e Kosovës do të përbënin shumicën e konsiderueshme” është rekomanduar nga Z. Kai Eide, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së në shqyrtimin e tij gjithëpërfshirës të Kosovës të publikuar në tetor 2005. Komisioni Këshillëdhënës apelon tek autoritetet të marrin parasysh parimet e Nenit 16 në përgatitjet e decentralizimit, si dhe të mbështeten në ekspertizën e bashkësisë ndërkombëtare në këtë fushë.

### **Neni 17**

120. Komisioni Këshillëdhënës thekson se e drejta e personave nga radhët e komuniteteve pakicë të gëzojnë kontakte të papenguara me personat që ju takojnë komuniteteve të tyre përkatëse garantohet me Kornizën Kushtetuese të Kosovës, edhe pse zbatimi i kësaj të drejte, në shumë aspekte, ndërlikohet nga *de facto* kufizimet në lirinë e lëvizjes së disa personave që ju takojnë komuniteteve pakicë.
121. Komisioni Këshillëdhënës thekson se janë ndërmarrë përpjekje për t'i adresuar vështirësitë e lidhura me mosnjohjen e dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut nga

vendet e rajonit (më konkretisht Bosnja dhe Hercegovina), dhe i mbështet përpjekjet e UNMIK-ut për të zgjeruar njohjen e këtyre dokumenteve të udhëtimit dhe për t'i mënjanuar pengesat e mbetura, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me njohjen e tabelave të regjistrimit të veturave të lëshuara nga UNMIK-u, në mënyrë që të garantohen kontaktet ndërkufitare për personat që ju takojnë komuniteteve pakicë.

## **Neni 18**

122. Komisioni Këshillëdhënës thekson se UNMIK-u ka hyrë në një numër marrëveshjesh të rëndësishme për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Këto përfshijnë Marrëveshjen me Këshillin e Evropës mbi Konventën Kornizë (shih poashtu edhe vërejtjet e Përgjithshme) si dhe marrëveshje me vendet e rajonit në fushën e rëndësishme të komuniteteve pakicë, si në kulturë dhe arsim. Komisioni Këshillëdhënës inkurajon përpjekjet për të promovuar përdorimin e këtyre instrumenteve për të shtyrë përpara mbrojtjen e personave që ju takojnë komuniteteve pakicë.

#### **IV. VËREJTJET PËRMBYLLËSE**

123. Komisioni Këshillëdhënës konsideron se vërejtjet përmbyllëse më poshtë pasqyrojnë shtysën kryesore të këtij opinioni dhe se mund të shërbejnë si bazë për konkludimet dhe rekomandimet që priten të miratohen nga Komiteti i Ministrave.

#### **KONKLUDIMET E PËRGJITHSHME**

124. Mbrojtja e pakicave kombëtare është një fushë e rëndësishme primare për të drejtat e njeriut si dhe për paqen dhe stabilitetin në Kosovë, dhe Marrëveshja e nënshkruar në mes të Këshillit të Evropës dhe UNMIK-ut lidhur me monitorimin e Konventës Kornizë është një hap i rëndësishëm në përmirësimin e përgjegjësisë së autoriteteve në Kosovë në këtë lëmi.

125. Procesi i monitorimit rastësitë me vendimin për nisjen e bisedave për statusin e ardhshëm të Kosovës, rezultatet e së cilit poashtu do të kenë ndikim në mënyrën se si do të trajtohen konkludimet e procesit aktual të monitorimit. Rregullimi institucional aktual kompleks e i paqartë, i shoqëruar me pasiguri sa i përket statusit të ardhshëm të Kosovës, në disa raste e kanë fshehur përgjegjësinë e autoriteteve përkatëse për implementimin e Konventës Kornizë, në dëm të personave që ju takojnë komuniteteve pakicë. Kësisoj, çfarëdo që të jetë rezultati i bisedimeve për status, është esenciale që autoritetet që janë përgjegjëse në Kosovë, qofshin ato ndërkombëtare dhe/ose vendore, në mënyrë të qartë t'i marrin përgjegjësitë e tyre për implementimin e këtij traktati.

126. Në të njëjtën kohë, është e qartë se, pavarësisht nga rregullimet institucionale, implementimi i parimeve të Konventës Kornizë mbetet jashtëzakonisht i vështirë në Kosovë, ku dhuna ndëretnike seriozisht ka dëmtuar besimin në mes të komuniteteve.

127. Normat e ndryshme të avancuara, si Ligji Kundër Diskriminimit, dhe Plani për Zbatimin e Standardeve për Kosovën kanë hyrë në fuqi për t'i trajtuar shqetësimet kryesore të komuniteteve pakicë.

128. Sidoqoftë, realiteti në Kosovë mbetet mjaft larg nga këto norma dhe plane të lavdërueshme. Armiqësia në mes të shqiptarëve dhe serbëve është ende mjaft e ndjeshme, dhe kjo është duke e dëmtuar edhe mbrojtjen e komuniteteve tjera në Kosovë.

129. Serbët jashtë vendbanimeve të tyre kompakte i shohin të drejtat e tyre themelore të kërcënuara, siç janë liria e lëvizjes dhe e të shprehurit, e diskriminimi dhe mostoleranca ndaj personave që ju takojnë komuniteteve pakicë vazhdojnë. Shqetësimet për siguri, së bashku me mundësitë e kufizuara të punësimit dhe me problemet lidhur me riposedimin e pronës dhe faktorët tjerë, janë pengesë reale për kthim të qëndrueshëm. Shqetësimet për siguri poashtu ndikojnë në implementimin e Konventës Kornizë në fushat si arsimi, përdorimi i gjuhëve dhe pjesëmarrja. Kjo ka të bëjë jo vetëm me serbë por edhe me anëtarë të komuniteteve tjera, posaçërisht romët.

130. Në këto rrethana të vështira disa iniciativa të vlefshme si plani për regjistrimin e popullatës dhe amvisërive duhet të trajtohen me kujdes të madh dhe në konsultime të ngushta me të gjitha komunitetet pakicë.
131. Progresi i qëndrueshëm drejt barazisë së plotë dhe efektive kërkon përkushtim të mirëfilltë nga institucionet që të merren me problemet e identifikuara. Janë vërejtur disa hapa përpara në këtë drejtim, por ende ka mangësi serioze sa i përket kapacitetit dhe vullnetit të institucioneve vendore që t'i trajtojnë këto çështje. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u disa herë ka qenë i ngadalshëm për të reaguar, dhe, për shembull, emergjenca shëndetësore në kampet e romëve në Kosovën veriore vetëm së voni është trajtuar si prioritet. Për më tepër, fakti se as UNMIK-u e as autoritetet vendore nuk kanë marrë përgjegjësi të qartë mbi disa çështje, ka shkaktuar vështirësi të konsiderueshme, për shembull, për ashkalinjtë dhe egjiptasit të cilët janë kthyer me dhunë në Kosovë.
132. Mosndëshkimi i perceptuar i aktorëve të krimeve të dhunës kundër serbëve, romëve dhe të tjerëve, duke përfshirë këtu edhe dhunën e marsit 2004, është problem posaçërisht serioz që duhet të adresohet si prioritet i lartë. Kjo kërkon përpjekje më të vendosura, nga organet vendore e ndërkombëtare në zbatimin e ligjit.
133. Gjyqësia, me numrin e madhe të lëndëve të pazgjidhura dhe me përfaqësimin e kufizuar të pakicave, është një element tejet i dobët në kornizën aktuale institucionale, dhe kjo ka ndikim negativ në përpjekjet e personave që ju takojnë komuniteteve pakicë që ta ushtrojnë të drejtën për kompensim prone dhe të drejta tjera. Për shumë sosh, Ombudspersoni ndërkombëtar mbetet i vetmi mjet ligjor i besuar dhe i mundshëm.
134. Ekzistojnë disa shembuj pozitiv të përdorimit të rregullt të gjuhëve të komuniteteve pakicë në organet zyrtare. Në të njëjtën kohë, mungesa e vullnetit politik dhe kapacitetit e ka kufizuar mundësinë e personave nga komunitetet pakicë që ta përdorin gjuhën e tyre në raporte me administratën publike në një numër vendbanimesh. Pos kësaj, progresi i raportuar mbi përdorimin e treguesve topografikë në gjuhët e pakicave është ende tepër i ngadalshëm.
135. Përderisa ekzistojnë disa iniciativa pozitive, nuk ka qasje gjithëpërfshirëse ndaj çështjes së arsimit të pakicave, dhe kjo ka pasur ndikim negativ në komunitetet numerikisht më të vogla, si në komunitetin boshnjak dhe turk. Nevojat specifike të nxënësve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas ende duhet të adresohen në mënyrë konsistente. Për më tepër, reformat e vazhdueshme arsimore kanë krijuar pengesa të reja në qasjen në arsim për disa nxënës goranë.
136. Fakti se nxënësit shqiptar dhe serb në përgjithësi e vijojnë mësimin e tyre në shkolla të ndara paraqet sfida të mëdha dhe afatgjata për ndërtimin e besimit dhe pajtimin në mes të dy komuniteteve. Përveç disa iniciativave të kufizuara për shkolla të përbashkëta, ekziston një mungesë bashkëveprimi në mes të këtyre komuniteteve përbrenda sistemit shkollor, që edhe e forcon natyrën e ndarjes së shoqërisë së Kosovës.

137. Korniza Kushtetuese përmban disa dispozita të lavdërueshme mbi pjesëmarrjen e personave nga komunitetet pakicë në proceset e vendimmarrjes, por pengesa serioze në nivele të ndryshme ende janë prezente në këtë fushë. Pjesëmarrja e komuniteteve tjera pos shqiptarëve dhe serbëve në bisedat për status është një shqetësim akut në këtë drejtim, dhe çështja tjetër kyçe është reforma e paraparë e qeverisë lokale.
138. Pjesëmarrja e personave nga komunitetet pakicë në jetën ekonomike dhe shoqërore është një fushë tjetër ku përkushtimi politik duhet të jetë më shumë i pasqyruar në praktikë, dhe ndikimi i privatizimit dhe proceset tjera kyçe duhet të monitorohen me kujdes.

## **REKOMANDIMET**

139. Përpos marrjes parasysh së komenteve të ndryshme të bëra në pjesët e mësipërme të Opinioneve aktual, autoritetet në Kosovë, ndërkombëtare dhe vendore, kërkohen të ndërmarrin masat vijuese me qëllim të përmirësimit të implementimit të Konventës Kornizë në Kosovë.

### **Të përgjithshme**

140. Të sigurohet se ka qartësi të mjaftueshme sa ju përket përgjegjësisë dhe llogaridhënies për implementimin e neneve të ndryshme të Konventës Kornizë dhe që asnjë kompetencë t-të mos delegohet para kohës tek institucionet vendore në sektorët përkatës.
141. Të ngritet vetëdijesimi përbrenda organeve përkatëse, ndërkombëtare dhe vendore, për parimet në Nenin 15 dhe neneve tjera të Konventës Kornizë.

### **Mbledhja e të dhënave**

142. Të shtyhet organizimi i regjistrimit të popullatës dhe amvisërive deri sa të sigurohet niveli maksimal i pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve.
143. Të ndërmerren masa për të siguruar mbrojtje efektive të dhënave personale lidhur me përkatësinë kombëtare.
144. Të themelohet një sistem permanent për mbledhjen e të dhënave mbi hetimin dhe përndjekjen e incidenteve në baza etnike.

### **Masat ligjore dhe zbatimi i ligjit**

145. Të shtohen përpjekjet për përmirësimin e funksionimit të gjyqësisë dhe të ndërtohet besimi i komuniteteve pakicë në gjykata, *inter alia*, duke rekrutuar persona që ju takojnë pakicave dhe duke rritur shpejtësinë me të cilën trajtohen rastet.

146. Të mbahet institucioni i Ombudspersonit nën udhëheqje ndërkombëtare deri sa të vlerësohet me siguri se institucioni në fjalë mund të funksionojë si institucion vendor pa e dëmtuar besimin të cilin deri më tani e ka ndërtuar në mesin e komuniteteve pakicë.
147. Të adresohet mosndëshkueshmëritë e perceptuara sa ju përket krimeve etnikisht të motivuara duke ju dhënë këtyre rasteve prioritetin më të lartë përbrenda zbatimit të ligjit dhe organeve tjera përkatës, dhe të ndërmerren hapa për të inkurajuar raportimin e rasteve të mostolerancës.

### **Procesi i kthimit dhe shqetësimet për siguri**

148. Të ndërmerren masa praktike të vendosura për mënjanimin e pengesave për kthim duke i adresuar me seriozitet shqetësimet për siguri por edhe duke siguruar ripsedimin, dhe qasjen e papenguar në pronën bujqësore dhe llojet tjera të pronës dhe duke disenjuar aktivitete shtesë për gjenerimin e të ardhurave.
149. Të zbatohen plane për t'i bërë skemat e asistencës më fleksibile në mënyrë që të garantohet më mirë liria e zgjedhjes së vendbanimit në Kosovë për persona që ju takojnë komuniteteve pakicë.
150. Të ndërmerren masa të asistencës, dhe të bëhet ndarja më e qartë e përgjegjësive institucionale, për të siguruar integrimin e shtuar të atyre personave që ju takojnë komuniteteve pakicë që janë kthyer dhunshëm në Kosovë.
151. Të ndërmerren masa urgjente për ta adresuar gjendjen alarmante shëndetësore të romëve në kampet e kontaminuara me plumb në Kosovën veriore, duke pasur prioritet mirëqenien dhe shëndetin e romëve dhe të merren masa të vendosura për ta menaxhuar kthimin e romëve dhe për të parandaluar ndonjë krizë shëndetësore të ngjashme në të ardhmen.

### **Kulturat e pakicave dhe çështjet mediale**

152. Të shtohen përpjekjet për mbrojtjen e objekteve fetare nga çfarëdo incidenti duke vazhduar procesin thelbësor të rindërtimit të objekteve të dëmtuara.
153. Të shtohen masat për përkrahjen e kulturave të komuniteteve pakicë, duke përfshirë këtu edhe komunitetet numerikisht më të vogla dhe të sigurohet pjesëmarrja e personave që ju takojnë komuniteteve pakicë në procesin e vendimmarrjes.
154. Të vazhdohet shpejtë me aplikimet për licenca të radiove dhe televizioneve, me qëllim të zgjerimit të veprimit dhe diversitetit të transmetimit për dhe nga komunitetet pakicë, dhe të ndërmerren hapa të mëtejme për të siguruar se të gjitha komunitetet kanë qasje të barabartë në shërbimin e transmetimit publik.

### **Përdorimi i gjuhës**

155. Të miratohet legjislacioni i ri për gjuhë ashtu që të sjell qartësi dhe siguri ligjore sa i përket përdorimit të gjuhëve, duke përfshirë këtu edhe në raporte me autoritetet administrative, treguesve topografik dhe regjistrimit të emrave personal, dhe të monitorohet për së afërmi respektimi i standardeve gjuhësore në sektorët përkatës si dhe në gjyqësi.
156. Të sigurohet se miratimi i legjislacionit të ri për gjuhë shoqërohet me kapacitet adekuat implementues dhe se procedurat, duke përfshirë edhe ato gjyqësore, janë në vend në rast të mosrespektimit të standardeve gjuhësore dhe të ndryshimeve joligjore të emrave të vendeve.
157. Të sigurohet se janë arritur rezultate të prekshme në përpjekjet për t'i dhënë fund ndjenjës së pasigurisë që i pengon serbët dhe romët dhe personat që ju takojnë komuniteteve tjera pakicë, ta përdorin gjuhën e tyre në vende publike.

### **Arsimi**

158. Të shqyrtohen mënyra për krijimin e mundësive të bashkëveprimit në mes të nxënësve të komunitetit serb dhe atij shqiptar dhe të përpilohet një plan gjithëpërfshirës i cili në vazhdimësi do t'i mënjanton barrierat, përfshirë edhe ato gjuhësore, në mes të nxënësve nga komunitete të ndryshme.
159. Të zgjidhen shqetësimet e pakicave dhe të ndërmerren masa stimuluese që do ta zvogëlonin kërkesën për ta mbajtur sistemin paralel të arsimit.
160. Të adresohet urgjentisht çështja e transportit të sigurt për nxënës nga komunitetet pakicë për në objektet arsimore.
161. Të adresohen nevojat ekzistuese për arsim në gjuhët e komuniteteve pakicë, si dhe të qartësohet kufiri për hapjen e një klase me mësim në gjuhën e pakicave në mënyrë që të plotësohen kërkesat e bëra nga komunitetet numerikisht më të vogla dhe të ndërmerren masa për sigurimin e teksteve shkollore adekuate dhe arsimtarëve të kualifikuar për mësimdhënie në gjuhën amtare.
162. Të sigurohet se janë ndërmarrë hapa të vendosur për t'i adresuar nevojat arsimore të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve, si dhe të sigurohet qëndrueshmëria e programeve që synojnë t'iu ndihmojnë nxënësve nga këto komunitete të integrohen dhe të mbesin në sistemin arsimor.
163. Të lejohet fleksibilitet në implementimin e reformave arsimore në raport me ata nxënës nga komuniteti goran të cilët ende nuk janë integruar në sistemin e ri arsimor.

### **Pjesëmarrja**

164. Të sigurohet pjesëmarrje dhe kontribut i mirëfilltë i personave që ju takojnë të gjitha komuniteteve në bisedat lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës.
165. Të vazhdohen përpjekjet për të ngritur pjesëmarrjen e personave nga komunitetet pakicë në strukturat dhe proceset e IPVQ-ve.
166. Të fillohet dialogu i rregullt në mes të Ministrive Qeveritare përkatëse dhe Komisionit mbi të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të Kuvendit të Kosovës.
167. Të shqyrtohen mundësitë e përmirësimit të përfaqësimit dhe efektivitetit të komisioneve të komuniteteve nëpër komuna.
168. Të shtohen përpjekjet për të siguruar se personat nga të gjitha komunitetet mund të marrin pjesë në jetën ekonomike dhe sociale në Kosovë, duke përfshirë edhe monitorimin se si ndikon dhe si përfshinë procesi i privatizimit komunitetet pakicë.

#### **Mbrojtja ndaj ndryshimeve të popullatës**

169. Të sigurohet se procesi i kthimit, krahas garantimit të zgjedhjes së vendbanimit në Kosovë, është i organizuar asisoj që i shmang manipulimet politike.
170. Të sigurohet se çfarëdo plani i propozuar i decentralizimit të mundësojë konsultime të mirëfillta me të gjitha komunitetet pakicë dhe të respektojë plotësisht parimet e Nenit 16 të Konventës Kornizë.

#### **Kontaktet ndërkufitare**

171. Të vazhdohen përpjekjet për t'i adresuar vështirësitë lidhur me mosnjohjen e dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut, duke përfshirë edhe ato lidhur me njohjen e tabelave të regjistrimit të lëshuara nga UNMIK-u.